



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
PREFEKTURËN ELBASAN

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE”

Tiranë, shkurt 2025

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
a. Përshkrim i shkurtër i institucionit.....	3
b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.	3
c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	3
d. Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:	3
e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	3
KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT	5
II. HYRJE	Error! Bookmark not defined.
1. Objektivat dhe qëllimi.....	Error! Bookmark not defined.
2. Identifikimi i çështjes.....	Error! Bookmark not defined.
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	Error! Bookmark not defined.
4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH	Error! Bookmark not defined.
5. Kriteret e vlerësimit.....	Error! Bookmark not defined.
6. Dokumentimi i rezultateve të auditimit	
III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	10
1. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT	10
2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, SI DHE ZBATIMI I KONTRATAVE TË PUNIMEVE.....	13
3. AUDITIM MBI VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTEVE NORMATIVE, URDHRAVE E URDHËRESAVE ME KARAKTER NORMATIV TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE.....	17
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	56

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Misioni i Prefektit të Qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Keshillit të Ministrave Arritja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve; Program që ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike, në nivel qarku. Prefektura Elbasan përbëhet nga 7 Bashki, Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, Peqin dhe Prrenjas, Bashki me një sipërfaqe territoriale **3,329** km². Prefekti i qarkut Elbasan e ushtron detyrën bazuar në Ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe Rregullores së brendshme të funksionimit.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Ky auditim ka rëndësi për arsye se, Prefektura Elbasan administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit. Auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit dhe të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie.

c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është nxjerja e konkluzioneve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe vendimarrëse të Prefektit me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësim me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Prefektura Elbasan. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit publik.
- mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së Akteve Normative të nxjerra nga Këshillat Bashkiak.

d. Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Prefektura e Qarkut Elbasan për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 14 gjetje dhe ka lënë 14 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Në 4 raste “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd”, mungon dokumentacioni pronësor i detyrueshëm i objekteve, mungon mënyra e

përfitimit të pasurive (Institucioni përgjegjës për administrim), nëse kanë ardhur si rezultat i transferimit nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë vendore referuar dispozitave të ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (Miratimi nga Këshilli i Ministrave, së bashku me dokumentacionin përkatës), mungojnë arsyet e nxjerrjes nga përdorimi, vlerësimet e ekspertit të fushës si dhe metoda që propozohet për daljen nga përdorimi referuar udhëzimit nr. 11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, komkretisht;

- Në 1 rast Këshilli Bashkiak Peqin me Vendimin nr. 32 date 21.06.2023 ka miratuar nisjen e procedurës “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit tip Benz Avangart” në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm konkretisht:

- Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

- Projektvendim;

- Relacioni i KB si dhe mungojnë arsyet e nxjerrjes nga përdorimi, vlerësimet e ekspertit të fushës si dhe metoda që propozohet për daljen nga përdorimi referuar udhëzimit nr. 11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Në 2 raste janë konfirmuar akte normative për “Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik” pa certifikatë pronësie dhe pa statusin juridik të pronës nga AShK, pa vlerë preventivi etj.

g. Rekomandimet më kryesore për përmirësimin e situatës:

- Prefekti i Qarkut Elbasan në cilësinë e të vetmit institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore, të marrë masa për rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj Bashkive në respektimin hap pas hapi të procedurave që ndiqen për konfirmimin e akteve normative, si dhe të mbajë korrespondenca me Bashkitë për dokumentimin e rasteve kur këto të fundit nuk do të vijnë me miratimin e akteve të refuzuara nga prefekti.

- Prefektura e Qarkut Elbasan të marrë masa që të mos pranojë dhe konfirmojë aktet normative të dërguara nga Bashkitë të pa shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues i cili garanton se vendimarrja ka respektuar të gjitha përcaktimet ligjore kur jepet në përdorim apo shfrytëzim një pasuri publike. Gjithashtu, të kërkohej nga Bashkitë që i gjithë dokumentacioni i dërguar nga Bashkitë të jetë i inventarizuar dhe me listën e dokumentacionit që përmban dosja.

- Prefektura e Qarkut Elbasan të marrë masa për shqyrtimin e kujdesshëm të dokumentacionit dhe hapave që kanë ndjekur Bashkitë në çështjet e dhënies në përdorim, tjetërsimit apo kalimit në pronësi të pasurive publike, duke mos u mjaftuar vetëm me faktin se baza ligjore është cituar në vendime dhe relacione, por të verifikohet edhe në mënyrë të dokumentuar se janë ezauruar të gjitha këto përcaktime ligjore, përpara vendimarrjes për përfundimin e procesit.

- Prefektura e Qarkut Elbasan të marrë masa për rikthimin për shqyrtim të rasteve të akteve normative të cilat kanë mospërputhje në dokumentacionin e dërguar, si dhe nuk garantojnë siguri të arsyeshme nëse është aplikuar baza e duhur ligjore.

- Prefektura e Qarkut Elbasan të marrë masa që në të ardhmen, gjatë periudhës 4 mujore të fushatave zgjedhore, të rikujtojë Bashkitë, si dhe të mos pranojë për shqyrtim asnjë akt normativ, vendimarrja e të cilit nuk ka lindur nga nevoja të rasteve të emergjencave apo parashikimeve të tjera në ligj.

KONKLuzioni I PëRGJITHSHëm DHE OPINIONI I AUDITIMIT

I.1. Opinioni i Auditimit.

A.

Për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit “Prefektura Qarkut Elbasan” për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Prefektura Qarkut Elbasan janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë dhe vlerën e materialitetit llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Në 21 raste, janë konfirmuar vendimet e këshillave bashkiak të marra në kundërshtim me Kodin zgjedhor dhe Vendimin nr. 9 të komisionit Rregullator pran Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendime të mara brenda periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve.

- Në 3 raste, verifikimet e vendimeve të këshillave bashkiakë me objekt përdorimin e fondit të kushtëzuar për emergjencat civile kanë mungesë të dokumentacionit bazë si akti i vlerësimit të dëmit, referencë të gabuar ligjore etj. Për rrjedhojë, nuk ka një vendimmarrje të unifikuar për vendimet të kësaj natyre, duke sjellë si pasojë që verifikimet e ligjshmërisë të jenë kontradiktore për vendime që për nga natyra dhe objekti janë të njëjta.

- Në 5 raste “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd”, mungon dokumentacioni pronësor i detyrueshëm i objekteve, mungon mënyra e përfitimit të pasurive (Institucioni përgjegjës për administrim), nëse kanë ardhur si rezultat i transferimit nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë vendore referuar dispozitave të ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (Miratimi nga Këshilli i Ministrave, së bashku me dokumentacionin përkatës), mungojnë arsyet e nxjerrjes nga përdorimi, vlerësimet e ekspertit të fushës si dhe metoda që propozohet për daljen nga përdorimi referuar udhëzimit nr. 11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në 2 raste janë konfirmuar akte normative për “Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik” pa certifikatë pronësie dhe pa statusin juridik të pronës nga ASHK, pa vlerë preventivi, etj.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit nr. 562/1prot., datë 31.05.2024 “Mbi auditimin e përputhshmërie” (i ndryshuar), të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 31.05.2024 – 12.7.2024, në subjektin Prefektura Qarkut Elbasan për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 - 31.12.2023, u krye “Auditimi i Përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. H. I, Përgjegjës Grupi,
2. A. L, Auditues,
3. S. H, Auditues.

➤ OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

a- Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit të përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Në përfundim të auditimit, do hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Prefektit të Qarkut Elbasan.

b- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të prefekturës dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Prefektit të Qarkut Elbasan.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Prefektit të Qarkut Elbasan.

c- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Prefekti i Qarkut Elbasan (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë dhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të

menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, si dhe shprehjen e ligjshmërive të vendimeve të këshillave bashkiak.

Prefekti nëpërmjet konfirmimit ose jo të vendimeve të Këshillave Bashkiak, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore fondet speciale të tyre, administrimin e pronave publike të bashkive, etj.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

d- Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit “Prefektura Qarkut Elbasan” për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, c) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Prefektit të Qarkut Elbasan është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

e- Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 115/2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimin MF nr. 1, datë 10.01.2022 “*Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022*”, pikat 95-122.

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e vlerësimit të vlefshmërisë së akteve: Ligji nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/n, neni 54; ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, etj.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Ligj Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Urdhri nr. 50 datë 12.04.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”; VKM nr. 117/2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” i ndryshuar; VKM nr. 707/2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore” i ndryshuar; Urdhri nr. 4 datë 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës organizative të Prefektit të Qarkut Elbasan” dhe VKM për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Institucionit të Prefektit.

- Në fushën e emergjencave dhe Mbrojtjen Civile: Ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen civile”; Ligji nr. 107 dt. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”; VKM nr. 923 datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimit e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndër-institucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”; VKM nr. 345 datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë”; VKM nr. 414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”; Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

f- Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

g- Metodatat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese të KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* – është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* – është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* – janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

h- Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, nga grupi i auditimit janë dorëzuar në zyrën e protokollit Prefektura Elbasan 5 akte (1 akt verifikime dhe 4 akt konstatime) nr. 508/4-9 prot, datë 26.07.2024, të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara. Pas shqyrtimit të kundërshtive në fazën e akt konstatimeve paraqitur me shkresën nr. 508/22 prot, datë 02.08.2024 (prot KLSH nr. 562/4, datë 05.08.2024) pas reflektimit nga grupi u përgatit ky Raport Auditimit i cili i përcillet subjekti për njohje dhe veprim.

III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

1. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër, pika 1, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit për periudhën 2022-2023, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.*

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- Vendimet "Për miratimin e buxhetit" për periudhë 2022-2023;
- Vendime në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për periudhë 2022-2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për periudhë 2022-2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

1. Programimi dhe realizimi i buxhetit 2022-2023

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:

Me urdhër të Kryeministrit nr 5 datë 12.01.2016 Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan", është miratuar numri i punonjësve të Prefektit të Qarkut Elbasan, dhe funksionet e deleguara për vitin 2022 dhe 2023, konkretisht 29 punonjës Prefekti i Qarkut Elbasan, 4 punonjës Gjendja Civile.

Për vitin 2022 PBA është dërguar në Ministrinë e Brendshme me shkresën nr.prot.926/4 date 10.08.2021 "Për dërgimin e PBA 2022-2024" dhe për vitin 2023 PBA janë dërguar në Ministrinë e Brendshme me shkresën nr.prot.968/2 date 10.08.2022 "Për dërgimin e PBA 2023-2025", si vijon:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Projekt Buxhet 2022	Buxheti Faktik 2023	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	21,704	24,441	26,026	24,283
601	Sigurime Shoqërore	3,601	3,999	4,304	4,132
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7,603	8,082	7,923	8,708
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	381	0	170	123
I	Shpenzime Korrente	33,289	36,522	38,423	37,246
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	400	12,173	0	11,245
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	400	12,173	0	0

230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0
II	Shpenzime Kapitale	400	12,173	0	11,245
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	33,689	48,695	38,423	48,491

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2022-2023

Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023
Të ardhurat faktike	282	203
Shpenzimet faktike	37,363	43,239

Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor, është dërguar dhe miratuar nga Ministria e Brendshme me shkresën nr.prot.10084/4 datë 27.01.2022 protokolluar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut nr.prot.39/2 datë 02.02.2022 dhe dërguar Ministrinë e Brendshme shpërndarja e miratuar bashkë me ralionin spjegues, duke argumentuar shpërndarjen e 7 shifërorit të artikullit 602, si dhe planin e çelur krahasuar me ate të paraqitur në PBA-në, me nr.prot.39/1 datë 27.01.2022 dhe për strukturën e Prefekturës është në vlerën 36,296 mijë lekë, ndërsa për strukturën Gjendja Civile në vlerën 2,800 mijë lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 282 mijë lekë, dhe shpenzimet kanë vlerën 37,363 mijë lekë.

Gjatë vitit 2022, janë akorduar nga Ministria e Brendshme dhe shtesa apo pakësime fondi, si rezultat i kërkesave të Institucionit, të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (e çelur në fillim të vitit buxhetor). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.601/6 dt.14.02.2022 “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2022”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.39/3 dt.02.02.2022, ku është dërguar plani vjetor dhe detajimi i fondit të veçantë për vitin 2022.

-Për artikullin 606 Programi Prefektura fondi i akorduar është në vlerën 100,000 lekë

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.2810/10 dt.15.04.2022 “Njoftim për pakësim të fondeve të shpenzimeve korente në zbatim të Aktit Normativ nr.3 dt.12.03.2022”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.39/10 dt.20.04.2022, ku është dërguar pakësim në limitet mujore dhe vjetore.

-Për artikullin 600 Programi Prefektura është pakësuar fondi në vlerën 660,000 lekë

-Për artikullin 601 Programi Prefektura është pakësuar fondi në vlerën 110,000 lekë

-Për artikullin 602 Programi Prefektura është pakësuar fondi në vlerën 840,000 lekë

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.4858/1 dt.18.05.2022 “Njoftim për transferim fondi”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.39/11 dt.23.05.2022, ku është dërguar shtesa e fondit për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

-Për artikullin 600 Programi Gjendja Civile fondi i akorduar është në vlerën 860,000 lekë

-Për artikullin 601 Programi Gjendja Civile fondi i akorduar është në vlerën 156,000 lekë

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.8149/3 dt.08.08.2022 “Njoftim për transferim fondi”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.39/12 dt.10.08.2022, ku është dërguar pakësim i fondit për fondin e veçantë

-Për artikullin 602 Programi Prefektura pakësuar fondi i akorduar në vlerën 22,000 lekë

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.8257/7 dt.24.08.2022 “Njoftim mbi detajimin e fondeve të shpenzimeve korente në zbatim të Aktit normative nr.12 datë 29.07.2022”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.39/13 dt.25.08.2022, ku është dërguar pakësim në limitet mujore dhe vjetore.

-Për artikullin 600 Programi Prefektura është pakësuar fondi në vlerën 1,100,000 lekë

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.8701/3 dt.13.09.2022 “Njoftim për tranfeërim fondi”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.39/14 dt.15.09.2022, ku është dërguar shtesë në limitin mujor dhe vjetor.

-Për artikullin 602 Programi Gjendja Civile është shtuar fondi në vlerën 30,000 lekë

-Nëpërmjet e-mailit në datë.29.09.2022 nga Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit ka vënë në dijeni për “Kërkesë raportim mbi problematikat financiare deri në mbylljen e vitit buxhetor 2022 si dhe për kërkesat buxhetore të vitit 2023 protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr.prot.39/18 dt.29.09.2022, për të cilat janë marrë masat përkatëse për raportimin në dt.30.09.2022 po nëpërmjet e-mailit, në kohë për reflektimet për vitin 2022 dhe kërkesat për vitin 2023 protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr.prot.39/19 dt.30.09.2022.

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.10599/3 dt.07.11.2022 “Njoftim për transferim fondi për investime”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.39/21 dt.08.11.2022, ku është dërguar shtesë në limitin vjetor, në përgjigje të informacionit të dërguar me e-mail protokolluar në institucionit tonë me nr.prot.39/19 dt.30.09.2022.

-Për artikullin 231 Programi Prefektura fondi i akorduar është në vlerën 400,000 lekë

*Nëpërmjet e-mailit në datë.04/05.01.2023 është kërkuar në drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar pranë Ministrisë së Brendshme, kërkesat për shtesa fondi dhe gjendjen e fondeve të lira, për mbulimn e shpenzimeve në zbatim të VKM-së nr.898 datë.29.12.2022 “Mbështetje financiare”, konkretisht:

-Për Programi Prefektura është nevojitur fondi në vlerën 320,000 lekë (kanë rezultuar fonde të lira 311,000 lekë si dhe është kërkuar një fond shtesë në vlerën 9,000 lekë)

-Për Programi Prefektura është nevojitur fondi në vlerën 40,000 lekë (kanë rezultuar fonde të lira 172,000 lekë)

*Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.13504/3 dt.17.01.2023 “Njoftim për një shtesë fondi në zbatim të VKM-së 898 dt.29.12.2022”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.1576/1-2 dt.17.01.2023, ku është dërguar shtesë në limitin mujor dhe vjetor.

-Për artikullin 602 Programi Prefektura është shtuar fondi në vlerën 320,000 lekë

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor, është dërguar dhe miratuar nga Ministria e Brendshme protokolluar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut nr.prot.91/1 datë 19.01.2023 dhe dërguar Ministrinë e Brendshme shpërndarja e miratuar bashkë me ralionin shpjegues, duke argumentuar shpërndarjen e 7 shifërorit të artikullit 602, si dhe planin e çelur krahasuar me atë të paraqitur në PBA-në, me nr.prot.91/1 datë 19.01.2023 dhe për strukturën e Prefekturës është në vlerën 35,518 mijë lekë, ndërsa për strukturën Gjendja Civile në vlerën 3,980 mijë lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 203 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 43,239 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023, janë akorduar nga Ministria e Brendshme dhe shtesa apo pakësime fondi, si rezultat i kërkesave të Institucionit, të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (e çelur në fillim të vitit buxhetor). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

*Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.1006/5 dt.23.02.2023 “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.91/2 dt.27.02.2023, ku është dërguar plani vjetor dhe detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023

-Për artikullin 606 Programi Prefektura fondi i akorduar është në vlerën 100,000 lekë

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.7063/3 dt.02.08.2023 “Njoftim për transferim fondi”, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.91/8 dt.02.08.2022, ku është dërguar shtesa e fondit për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

-Për artikullin 600 Programi Prefektura fondi i akorduar është në vlerën 5,000,000 lekë

-Për artikullin 601 Programi Prefektura fondi i akorduar është në vlerën 850,000 lekë

-Për artikullin 600 Programi Gjendja Civile fondi i akorduar është në vlerën 770,000 lekë

-Për artikullin 601 Programi Gjendja Civile fondi i akorduar është në vlerën 140,000 lekë

-Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.9782/1 dt.21.09.2023 “njoftim për transferim fondi”,protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.91/15 dt.25.10.2023, ku është dërguar shtesë plani vjetor dhe detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023.

-Për artikullin 606 Programi Prefektura fondi i akorduar është në vlerën 70,000 lekë

-Nëpërmjet e-mailit në datë.06.11.2023 nga Drejtoria e Koordinimit dhe Monitorimit janë vënë në dijeni për “Kërkesë mbi realizimin e pritshëm të buxhetit 2023 si dhe për kërkesat për rialokime fondesh buxhetore të vitit 2023 protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr.prot.91/18 dt.06.11.2023, nga institucioni janë marrë masat përkatëse për raportimin në dt.06.11.2023 po nëpërmjet e-mailit dhe shkresore duke e argumentuar cdo kërkesë për ndryshim fondi, në kohë për reflektimet për vitin 2023 protokolluar në Institucionin e Prefektit me nr.prot.91/19 dt.06.11.2023, konultuar nga Grupi i Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit, miratuar nga NA, si dhe shkresës me nr.prot 91/20 dërguar Ministrisë së Brendshme.

Pakësim:

Programi	Llogarieekonomike	Kodithesarit	KodProdukti	Shuma
01160	6000000	0808	91602AA	2,500,000
01160	6010000	0808	91602AA	430,000
			Shuma	2,930,000

Pakësim:

Programi	Llogarieekonomike	Kodithesarit	KodProdukti	Shuma
01170	6000000	0808	91603AA	40,000
01170	6010000	0808	91603AA	25,000
			Shuma	65,000

*Me shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.prot.17233/1 dt.16.11.2023 “Njoftim për transferim fondi”,protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me nr.prot.91/21 dt.23.11.2023, është dërguar pakësim i fondit për paga :

-Për artikullin 600 Programi Prefektura është pakësuar fondi në vlerën 1,960,000 lekë

2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimi i kontratave të punimeve

Për vitin 2022 është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nr. 68 prot. datë 24.01.2022, me Urdhër nr.15 datë 24.01.2022 të Titullarit të AK znj. M. P., i përbërë nga:

1.A. K. Kryetar - Përgjegjës në sektorin e Zhvillimit Urban

2.A. G. - Anëtar – Përgjegjës i Sektorit Juridik

3.A. G. - Anëtar – Specialist në Sektorin Juridik

Për vitin 2023 është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nr. 89 prot. datë 19.01.2023, me Urdhër nr.19 datë 19.01.2023 të Titullarit të AK znj. M. P., i përbërë nga:

1.A. K. - Kryetar - Përgjegjës në sektorin e Zhvillimit Urban

2.A. G. - Anëtar – Përgjegjës i Sektorit Juridik

3.A. G. - Anëtar – Specialist në Sektorin Juridik

Prefektura e Qarkut Elbasan për periudhën objekt auditimi nuk ka realizuar procedura me vlerë të lartë, por sipas viteve ka realizuar prokurime me vlera të vogla për blerjen e artikujve dhe shërbimeve si dhe të grup artikujve dhe grup-shërbimeve 4 procedura blerje me vlerë të vogël në vlerën 1,307,409 lekë për vitet 2022 – 2023 dhe 49 procedura blerje nën vlerën 100,000 lekë në vlerën 3,262,799 lekë për vitet 2022 – 2023.

Nga auditimi i **zonës së llogarisë 602**, për blerjet me vlera të vogla, rezultoi se janë zhvilluar për periudhën objekt auditimi blerje me vlerë të vogël sa vijon:

Vitet	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
		Numri	Vlera pa tvsh	Numër	Vlera pa tvsh	numër	vlerë	në % ndaj totalit
Viti 2022	Blerje me Vlerë të Vogël	2	647,249	2	477,714	2	477,714	100
	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	23	1,594,442	23	1,415,015	10	774,275	55
Viti 2023	Blerje me Vlerë të Vogël	2	858,984	2	829,695	2	829,695	100
	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	26	1,849,000	26	1,847,784	10	869,002	47
Totali		53	4,950,675	53	4,570,208	24	2,950,686	65

Bazuar tek vlerësimi i riskut janë kampionuar për t'u audituar në total 4 procedura prokurimi me vlerë të vogël, në vlerën 1,307,409 lekë ose 100% e vlerës. Procedurat e prokurimit me blerje me vlera të vogla, të audituara me të dhënat specifike sipas UMF nr. 5, datë 26.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Nomer rendor	Objekti	Urdher prokurimi		OE fitues	Klasifikuar në rradhitje ne shtep	Vlera e fituar	Urdher shpenzimi numër datë	Fatura tatimore		Akti i marrjes në dorëzim datë
		Nr	datë					Nr	datë	
1	Sherbime pastrimi	2	07.04.2022	D. & C. shpk	1	368,657	UB 2 date 7.04.2022	30/2022	10.05.2022	
2	Pjese kembimi	31	01.012.2022	A. B.	2	150,000	Nr 278 date 20.12.2022	11/2022	20.12.2022	Nr 1389/13 date 20.12.2022
1	Shërbime pastrimi	8	25.04.2023	D. & C. shpk	3	539,736	UB 4 date 03.05.2023	43/2023	05.06.2023	
2	Karburant	11	09.05.2023	D.	1	480,000	UB 6 date 15.06.2023	3974/2023	01.08.2023	544/21 date 01.08.2023

Tabela e procedurave të prokurimit me blerje me vlerë të vogël të audituara për vitin 2022 nën kufirin monetar 100,000 lekë.

në lekë

Nomer rendor	Objekti	Kërkesa (Po/Jo)	Urdher prokurimi		OE fitues	Klasifikuar në rradhitje ne shtep	Vlera e fituar	Urdher shpenzimi numër datë	Fatura tatimore			proced ligj (Po/Jo)	Akti i marrjes në dorëzim datë
			Nr	datë					Nr	datë	Vlerë		
1	Blerje materiale mbrojtese ndaj Covid -19		2	14.02.2022	C.	1	120 000	Nr 39 date 18.02.2022	1977/2022	14.02.2022	120 000		Nr 188/12 date 14.02.2022
2	Mirmbajtje e paisjeve te zyrave		5	04.03.2022	A. L.	1	15 000	Nr 67 date 31.03.2022	14/2022	04.03.2022	15 000		Nr 301/4 date 04.03.2022
3	Materiale per pastrim dhe dizifektim		11	15.04.2022	T. shpk	1	107 868	Nr 91 date 29.04.2022	1/2022	27.04.2022	107 868		Nr 517/7 date 27.04.2022
4	Filtra dhe Vaj		13	10.06.2022	A. I.	1	59 500	Nr 138 date 29.06.2022	3,4/2022	27.06.2022	59 500		Nr 737/6 date 27.06.2022
5	Kancelari		15	06.07.2022	Shtypshkronja A. shpk	1	119 000	Nr 157 date 08.07.2022	70/2022	06.07.2022	119 000		Nr 830/14 date 06.07.2022
6	Mirmbajtje te rrjeteve elektrike		17	07.07.2022	M. L.	1	56 000	Nr 161 date 20.07.2022	67/2022	07.07.2022	56 000		Nr 842/4 date 07.07.2022
7	Mirmbajtje e paisjeve teknike		19	12.08.2022	B. H.	1	49 998	Nr 187 date 16.08.2022	1/2022	15.08.2022	49 998		Nr 972/4 date 15.08.2022

8	Sherbim per lidhjen dhe sistemimin e librave te Gj.Civile		23	03.11.2022	Shtypshkronja A. shpk	1	30 000	Nr 244 date 21.11.2022	140/2022	10.11.2022	30 000		Nr 1281/4 date 10.11.2022
9	Shpz per mirmbajtje objekte ndertimore		24	17.11.2022	A. shpk	1	119 909	Nr 245 date 22.11.2022	164/2022	18.11.2022	119 909		Nr 1347/5 date 21.11.2022
10	Te tjera paisje zyre (printer)		33	19.12.2022	E.	1	97 000	Nr 277 date 20.12.2022	2351/2022	20.12.2022	97 000		Nr 1481/8 date 20.12.2022

Tabela e procedurave të prokurimit me blerje me vlerë të vogël të audituara 2023

në lekë

Nomer rendor	Objekti	Kërkesa (Po/Jo)	Urdher prokurimi		OE fitues	Klasifikuar në rradhitje ne shtep	Vlera e fituar	Urdher shpenzimi numër datë	Fatua tatimore			proced ligj (Po/Jo)	Akti i marrjes në dorëzim datë
			Nr	datë					Nr	datë	Vlerë		
1	Blerje dokumentcioni		4	03.04.2023	Shtypshkronja A. shpk	1	59 700	Nr 49 date 06.04.2024	34/2023	03.04.2023	59 700		Nr 411/6 date 03.04.2023
2	Fotokopjime		7	12.04.2023	M.S.	1	99 990	Nr 56 date 28.04.2023	52/2023	20.04.2023	99 990		Nr 464/4 date 20.04.2023
3	Sherbime dezifektimi		14	08.06.2023	I. M.	1	42 000	Nr 93 date 13.06.2023	6/2023	09.06.2023	42 000		Nr 648/4 date 09.06.2023
4	Pjese kembimi		15	14.06.2023	A. B.	1	100 000	Nr 103 date 23.06.2023	7/2023	21.06.2023	100 000		Nr 697/3 date 21.06.2023
5	Shpenz.per sigurim te mjeteve te transportit		18	15.08.2023	S.	1	36 946	N r 140 date 30.08.2023	210428/2023 210429/2023	16.08.2023	36 946		
6	Sherbime te tjera (mirmb ëebfaqe ,hostim etj)		21	21.08.2023	E. B.	1	99 600	Nr 159 date 19.09.2023	46/2023	18.09.2023	99 600		
7	Kancelari		23	05.10.2023	Shtypshkronja A. shpk	1	117 866	Nr 171 date 11.10.2023	112/2023	06.10.2023	117 866		Nr 1124/15 date 06.10.2023
8	Shpz. per mirmbajtje te tokave dhe aktiveve natyrore		28	15.11.2023	U. Shpk	1	119 400	Nr 202 date 20.11.2023	23/2023	15.11.2023	119 400		Nr 1252/7 date 17.11.2023
9	Mirmbajtje paisje zyre		30	21.11.2023	E.	1	118 000	Nr 205 date 24.11.2023	1875/2023	21.11.2023	118 000		Nr 1155/16 date 21.11.2023
10	Materiale per sherbime speciale (shkume per fikse zjarri ,etj)		32	21.11.2023	V. Y.	1	74 500	Nr 206 date 24.11.2023	56/2023	22.11.2023	74 500		Nr 1267/11 date 23.11.2023

- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”, fondi limit nuk ka qenë mbi 1,000,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 285 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II si dhe UMF nr. 5, datë 26.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”,.

- Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.

- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.
- Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit.
- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.
- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).
- Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali-ve të kryera nga AK(njoftimi) dhe OE (përgjigja).
- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.
- Në të gjitha rastet AK ka bërë përlllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.
- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje të vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014, “Për zhvillimin e Prokurimeve me vlerë të vogël në sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik “ku thuhet shprehimisht që *“Autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimi e procedurës së prokurimit brenda 1ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues”*, pasi faza arkivimit të kontratës është e papërfunduar.
- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

Konkluzion: Nga auditimi i pagesave për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se procedurat në përgjithësi ishin të plotësuara dhe dokumentacioni bashkëlidhur përbën gjurmën e auditimit të këtyre procedurave në të gjitha fazat dhe hapat e kryera për realizimin e këtyre procedurave deri në momentin e kontabilizimit të tyre në përputhje me e VKM nr. 285 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” të ndryshuar. dhe me UMF nr.57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

3. AUDITIM MBI VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTEVE NORMATIVE, URDHRAVE E URDHËRESAVE ME KARAKTER NORMATIV TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

3.1. Auditim mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore për vitin 2022

I - Zbatimi i afateve mbi shprehjen e ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut

Bazuar në nenin 16 pika 2/b të Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” në lidhje me afate kohore të shprehjes së ligjshmërisë për vendimet e marra nga Këshillat e Bashkive të NJVV të qarkut Elbasan dhe Këshilli i Qarkut Elbasan, ku parashikohet se:

- për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, **brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit...**, dhe në Urdhrin e Ministrit të

Brendshëm nr.667 datë 18.12.2018 “Për raportimin dhe informimin mbi veprimtarinë e prefekti të qarkut” pika 1, ku parashikohet se:

Prefekti i qarkut raporton dhe informon në mënyrë periodike Ministrin e Brendshëm mbi veprimtarit sipas shtojcës nr.1 të këtij urdhri të kryer në përmbushje të misionit të përgjegjësisë dhe funksioneve të tij. Informacioni të dërgohet me shkrim dhe në mënyrë elektronike brenda datës 5 të çdo muaji.

Referuar raportit mbi veprimtarinë e Institucionit të Prefektit të Qarkut për vitin 2022, Nr.08 Prot., datë 05.01.2023, nga auditimi rezulton se:

1. Këshilli i Qarkut Elbasan

-Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli i Qarkut Elbasan ka përcjell 41 akte. të karakterit normativ, që sipas raportit janë në përputhjeje me bazën ligjore në fuqi, dhe asnjë akt nuk është kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

2. Bashkia Elbasan

-Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli Bashkiak i Elbasanit ka përcjell 175 akte. Nga të cilat 169 akte të karakterit normativ janë në përputhjeje me bazën ligjore në fuqi, dhe 6 akte janë kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

3. Bashkia Belsh

-Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli Bashkiak Belsh ka përcjell 78 akte. Nga të cilat 76 akte të karakterit normativ janë në përputhjeje me bazën ligjore në fuqi, dhe 2 akte janë kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

4. Bashkia Cërrik

-Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli Bashkiak Cërrik ka përcjell 93 akte. Nga të cilat 88 akte të karakterit normativ janë në përputhjeje me bazën ligjore në fuqi, dhe 5 akte janë kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

5. Bashkia Librazhd

-Në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli Bashkiak Librazhd ka përcjell 102 akte. Nga të cilat 91 akte të karakterit normativ janë në përputhjeje me bazën ligjore në fuqi, dhe 11 akte janë kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

6. Bashkia Prrenjas

-Në institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli Bashkiak Prrenjas ka përcjell 111 akte. Nga të cilat 101 akte të karakterit normativ janë në përputhjeje me bazën ligjore në fuqi, dhe 10 akte janë kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

7. Bashkia Gramsh

-Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli Bashkiak Gramsh ka përcjell 103 akte. Nga të cilat 91 akte të karakterit normativ janë në përputhjeje me bazën ligjore në fuqi, dhe 11 akte janë kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

8. Bashkia Peqin

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, Këshilli Bashkiak Peqin ka përcjell 60 akte. Nga të cilat 57 akte të karakterit normativ janë në përputhje bazën ligjore në fuqi, dhe 3 akte janë kthyer për plotësim dokumentacioni.

-Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan janë respektuar afatet kohore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi

Në tabelën nr. 1, pasqyrohet në mënyrë të përmblëdhur veprimtaria e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan për vitin 2022, mbi verifikimin e akteve

Tabela nr.1. Verifikimi i akteve për vitin 2022 në Qarkun e Elbasani

Nr.	I				II	
	VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE					
	Njësi të vetëqeverisjes vendore	Aktet gjithsej të hyra te Prefekti	Të bazuara në ligj	Të pabazuara në ligj	Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve	Dërguar në gjykatë
A	Këshilli i Qarkut	41	41	0	33	
B	Bashkitë					
1	Bashkia Elbasan	175	169	6	129	
2	Bashkia Belsh	78	76	2	72	
3	Bashkia Cërrik	93	88	5	79	
4	Bashkia Librazhd	102	91	11	88	
5	Bashkia Prenjas	111	101	11	75	
6	Bashkia Gramsh	103	94	9	91	
7	Bashkia Peqin	60	57	2	44	
Shuma B		722	676	46	578	
Total Qarku (A+ B)		763	717	46	611	

Burimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan

Nga auditimi rezulton se:

Për vitin 2022, afatet kohore në lidhje me miratimin e akteve nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan dhe përcjelljes së Vendimeve të Këshillave Bashkiak të NJVV respektive të Qarkut Elbasan, janë respektuar sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

II- Verifikimin nga prefekti i qarkut i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Në mbështetje Nenin 17 i Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”; Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); dhe nenit 3 pika 2 e ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, ka kryer verifikimi në terren.

Nga ana e sektorit juridik të institucionit të prefektit të Qarkut Elbasan, janë zhvilluar kontrole periodike në NJVQV të Qarkut Elbasan.

Në zbatim të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut” neni 17 për vitin 2022 institucioni i prefektit të qarkut Elbasan, ka përcjell programet e verifikimit në terren mbi ligjshmërinë e akteve normative në Bashkinë Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, Prenjas, Peqin dhe Këshillin e Qarkut Elbasan me objekt:

-Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të miratuara nga Këshilli Bashkiak/Qarku

-Respektimi i ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16.

-Respektimi i ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar

-Ligjshmërinë e akteve normative që nuk janë dërguar për shprehje ligjshmërie tek Prefekti

-Verifikimin në vend i ligjshmërisë së akteve normative të miratuara nga Kryetari i Bashkisë

Në tabelën nr.2 janë pasqyruar programet dhe raportet me konkluzione dhe rekomandimet për vitin 2022, të realizuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan

Tabela nr.2.

Nr.	Programi i verifikimit	Njësia vendore	Periodha e verifikimit	Konkluzione dhe rekomandime të institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan
1	Nr.470 Prot. date 05.04.2022	Bashkia Belsh	Janar - Mars 2022	Me shkresën nr. 470/1 Prot date 29.04.2022 janë përcjell nga institucioni i prefektit te qarkut Elbasan konkluzionet dhe rekomandimet për bashkinë Belsh për periudhën janar – Mars 2022
2	Nr.866 Prot. date 28.02.2022	Bashkia Belsh	Prill - Qershor 2022	Për vendimin nr.40 date 08.06.2022 të këshillit bashkiak Belsh para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar te dhëna plotësuese, te cilat nuk janë dërguar pranë institucionit te prefektit te qarkut deri ne datën e mbajtjes se Akt Verifikimit nga grupi i punës se institucionit te Prefektit te qarkut Elbasan. Rekomandime: Nuk ka
3	Nr.67 Prot date 13.01.2023	Bashkia Belsh	Korrik - Dhjetor 2022	Me shkresën 67/1 Prot date 08.02.2023 është përcjell bashkisë Belsh konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit te kryer nga grupi i punës
4	Nr.469 Prot. date 05.04.2022	Bashkia Cërrik	Janar - Mars 2022	Me shkresën 469/1 Prot date 29.04.2022 është përcjell bashkisë cërrik konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit te kryer nga grupi i punës
5	Nr.867 Prot., date 18.07.2022	Bashkia Cërrik	Prill - Qershor 2022	Me shkresën nr. 867/1 Prot. date 31.08.2022 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandime mbi ligjshmërinë e akteve te miratuara nga këshilli bashkisë cërrikë. Konkluzion: Për vendimin nr.33 date 29.04.2022 te këshillit bashkiak para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar te dhëna plotësuese, te cilat nuk janë dërguar pranë institucionit te prefektit te qarkut deri ne datën e mbajtjes se Akt Verifikimit nga grupi i punës se institucionit te Prefektit te qarkut Elbasan. Rekomandime: Nuk ka
6	Nr.68 Prot. date 13.01.2023	Bashkia Cërrik	Korrik - Dhjetor 2022	Me shkresën 68/1 Prot date 20.02.2023 është përcjell bashkisë Cërrik konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit te kryer nga grupi i punës
7	Nr. 467 Prot., date 05.04.2022	Bashkia Elbasan	Janar - Mars 2022	Me shkresën 467/1 Prot date 29.04.2022 është përcjell bashkisë Elbasan konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit te kryer nga grupi i punës
8	Nr. 868 Prot. date 18.07.2022	Bashkia Elbasan	Prill - Qershor 2022	Me shkresën nr. 868/1 Prot. date 31.08.2022 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandimet mbi ligjshmërinë e akteve të miratuara nga këshilli i bashkisë Elbasan. Konkluzion: Nuk janë konstatuar akte me karakter normativ te padepozituara për shprehje ligjshmërie ne Institucionin e Prefektit te Qarkut Elbasan. Rekomandim: Nuk ka
9	Nr.63 Prot date 13.01.2023	Bashkia Elbasan	Korrik - Dhjetor 2022	Me shkresën 63/1 Prot date 03.02.2023 është përcjell bashkisë Librazhd konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit te kryer nga grupi i punës
10	Nr.491 Prot., date 04.04.2022	Bashkia Gramsh	Janar - Mars 2022	Me shkresën 491/1 Prot date 29.04.2022 është përcjell bashkisë Gramsh konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit te kryer nga grupi i punës
11	Nr.869 Prot date 18.07.2022	Bashkia Gramsh	Prill - Qershor 2022	Me shkresën nr. 869/1 Prot. date 31.08.2022 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandimet mbi ligjshmërinë e akteve të miratuara nga këshilli i bashkisë Gramsh. Konstatim: Për vendimi nr.50 datë 31.05.2022 para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar të dhëna plotësuese të cilat nuk janë dërguar deri në datën e mbajtjes se akt verifikimit ne bashkinë Gramsh. Rekomandime: ... Çdo akt para se te diskutohet ne mbledhjen e këshillit duhet te shqyrtohet nga komisioni kompetent. Komisioni duhet te mbaje proces verbal për mbledhjet e tij i cili duhet te jete pjese e dosjes se aktit....

12	nr.69 Prot date 13.01.2023	Bashkia Gramsh	Korrik - Dhjetor 2022	Me shkresën 69/1 Prot date 22.02.2023 është përcjell bashkisë Gramsh konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit të kryer nga grupi i punës
13	Nr.473 Prot. date 05.04.2022	Bashkia Librazhd	Janar - Mars 2022	Për vendimin nr.14 date 28.02.2022, nr.16 date 28.02.2022, nr.29 date 29.03.2022 të këshillit bashkiak Librazhd para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar të dhëna plotësuese, të cilat nuk janë dërguar pranë institucionit të prefektit të qarkut deri në datën e mbajtjes së Akt Verifikimit nga grupi i punës së institucionit të Prefektit të qarkut Elbasan. Rekomandime: Nuk ka
14	Nr. 870 Prot. date 18.07.2022	Bashkia Librazhd	Prill - Qershor 2022	Me shkresën 870/1 Prot. date 31.08.2022 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandimet mbi ligjshmërinë e akteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak Librazhd. Konkluzion:.. Për vendimet nr. 35 date 26.04.2022, nr.51 date 31.05.2022, nr. 57 date 30.06.2022 dhe nr. 61 date 30.06.2022 të këshillit bashkiak para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar të dhëna plotësuese, të cilat nuk janë dërguar pranë institucionit të prefektit të qarkut deri në datën e mbajtjes së Akt Verifikimit nga grupi i punës së institucionit të Prefektit të qarkut Elbasan. Rekomandime: ... Çdo akt para se të diskutohet në mbledhjen e këshillit duhet të shqyrtohet nga komisioni kompetent. Komisioni duhet të mbaje proces verbal për mbledhjet e tij i cili duhet të jetë pjesë e dosjes së aktit....
15	Nr.66 Prot date 13.01.2023	Bashkia Librazhd	Korrik - Dhjetor 2022	Me shkresën 66/1 Prot date 10.02.2023 është përcjell bashkisë Librazhd konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit të kryer nga grupi i punës
16	Nr.472 Prot date 05.04.2022	Bashkia Prenjas	Janar - Mars 2022	Me shkresën 172/1 Prot. date 29.04.2022 është përcjell bashkisë Përrenjas konkluzionet dhe rekomandimet nga prefekti i qarkut Elbasan mbi bazën e akt verifikimit të mbajtur me date 06.04.2022 nga grupi i punës
17	Nr.865 Prot date 18.07.2022	Bashkia Prenjas	Prill - Qershor 2022	Për vendimin nr.27 date 04.05.2022 nuk është konfirmuar për shkak se ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Për vendimin nr.45 date 31.05.2022 para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar të dhëna plotësuese, pas dërgimit të tyre akti u konfirmua në parim si i mbështetur në ligj.
18	Nr.64 Prot date 13.01.2023	Bashkia Prenjas	Korrik - Dhjetor 2022	Me shkresën 64/1 Prot date 10.02.2023 është përcjell bashkisë Librazhd konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit të kryer nga grupi i punës
19	Nr.468 Prot., date 05.04.2022	Këshilli i Qarkut Elbasan	Janar - Mars 2022	Me shkresën 468/1 Prot date 29.04.2022 është përcjell Këshillit të qarkut Elbasan konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit të kryer nga grupi i punës
20	Nr.872 Prot. date 18.07.2022	Këshilli i Qarkut Elbasan	Prill - Qershor 2022	Me shkresën nr. 872/1 Prot. date 31.08.2022 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandimet mbi ligjshmërinë e akteve të miratuara nga këshilli i Qarkut. Konkluzion: Nuk janë konstatuar akte me karakter normativ të padepozituara për shprehje ligjshmërie në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan. Rekomandime: Nuk ka.
21	Nr. 62 Prot date 13.01.2023	Këshilli i Qarkut Elbasan	Korrik - Dhjetor 2022	Me shkresën 62/1 Prot date 27.02.2023 është përcjell bashkisë Librazhd konkluzionet dhe rekomandimet e verifikimit të kryer nga grupi i punës
22	Nr.471 Prot. Date 05.04.2022	Bashkia Peqin	Janar - Mars 2022	Me shkresën nr.47/1 Prot. Date 29.04.2022 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandimet mbi ligjshmërinë e akteve të miratuara nga Bashkia Peqin. Konkluzion: Nuk janë konstatuar akte me karakter normativ të padepozituara për shprehje ligjshmërie në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan

23	Nr.871 Prot. Date 18.07.2022	Bashkia Peqin	Prill Qershor 2022	- Me shkresën nr.871/1 Prot. Date 31.08.2022 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandimet mbi ligjshmërinë e akteve të miratuara nga Bashkia Peqin. Për vendimin nr.23 date 26.05.2022 para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar të dhëna plotësuese, të cilat deri me datën që është mbajtur akt i verifikimit në Bashkinë Peqin nuk janë përcjell në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan
24	Nr.65 Prot. Date 13.01.2023	Bashkia Peqin	Korrik Dhjetor 2022	- Me shkresën nr.65/1 Prot. Date 13.01.2023 janë përcjell konkluzionet dhe rekomandimet mbi ligjshmërinë e akteve të miratuara nga Bashkia Peqin. Konkluzion: Nuk janë konstatuar akte me karakter normativ të padepozituara për shprehje ligjshmërie në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan

Burimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan përpunimi nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi rezulton se:

Për vitin 2022, Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, ka realizuar në total 24 verifikime në terren, dhe për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore janë realizuar 3 verifikime, pasi në 6 mujorin e dytë të vitit 2022, verifikimi në terren është realizuar për periudhën 6 mujore dhe jo për çdo periudhë 3 mujore, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2016 “ Për prefektin e qarkut” neni 17, ku parashikohet se:

Verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj

Nga auditimi i dokumentacionit mbi verifikimin në vend të zbatimit të ligjshmërisë, rezulton se:

-Rekomandimi i grupit të punës për verifikimin në Bashkinë Gramsh, nuk ka përputhje me konstatimin e grupit të verifikimit në lidhje me vendimin nr.50 datë 31.05.2022, ku para shprehjes mbi ligjshmërisë së aktit janë kërkuar të dhëna plotësuese të cilat nuk janë dërguar deri në datën e mbajtjes së akt verifikimit në Bashkinë Gramsh pranë institucionit të prefektit të qarkut Elbasan
-Në Akt verifikimi datë 08.04.2022, i mbajtur në Këshillin e Qarkut Elbasan mungon firma e sekretarit të Këshillit të Qarku dhe Akt Verifikimi është i pa protokolluar në Këshillin e Qarkut Elbasan.

- Akt verifikimi i datës 25.07.2022 i mbajtur pranë Bashkisë Librazhd nuk është i protokolluar.

-Akt verifikimi i datës 20.07.2022 i mbajtur në Këshillin e Qarkut Elbasan nuk është i protokolluar

-Akt Verifikimi i datës 05.04.2022 i mbajtur në Bashkinë Cërrik nuk është i protokolluar dhe nuk është firmosur nga sekretari i k/bashkiak Cërrik.

- Akt verifikimi i datës 28.07.2022 nuk është protokolluar dhe nuk është firmosur nga sekretari i Këshillit Bashkiak Përrenjas.

-Akt verifikimi i datës 06.04.2022 i mbajtur në Bashkinë Përrenjas nuk është i protokolluar dhe nuk është i firmosur nga sekretari i këshillit bashkiak të Përrenjasit

-Akt verifikimi i grupit të punës i datës 06.04.2022 i mbajtur në Bashkinë Librazhd nuk është i protokolluar

-Mungon akt verifikimi për periudhën janar mars për Bashkinë Belsh

-Mungon akt verifikimi për periudhën janar mars për Bashkinë Cërrik

-Mungon akt verifikimi për periudhën janar mars për Këshillin e Qarkut Elbasan.

-Mungon akt verifikimi për periudhën janar mars për Bashkinë Elbasan.

-Akt Verifikimi i datës 04.04.2022 i mbajtur në Bashkinë Gramsh nga A. G. dhe E. Z. i nënshkruar nga Xhulia Gjini në cilësinë e sekretarit të K/bashkiak Gramsh me nr. 4735/1 date 21.11.2022, megjithëse i përkiste verifikimit të periudhës janar mars 2022, është protokolluar 7 muaj pas datës së mbajtjes së tij.

-Akt verifikimi për periudhën korrik dhjetor 2022 në Bashkinë Cërrik nuk është protokolluar

-Akt verifikimi për periudhën korrik dhjetor 2022 në Bashkinë Belsh nuk është protokolluar

-Akt verifikimi për periudhën korrik dhjetor 2022 në Bashkinë Librazhd nuk është protokolluar

-Akt verifikimi për periudhën korrik dhjetor 2022 në Bashkinë Përrenjas nuk është i protokolluar
-Akt verifikimi për periudhën korrik dhjetor 2022 në Bashkinë Elbasan nuk është i protokolluar
-Akt verifikimi për periudhën korrik dhjetor 2022 në Këshillin e Qarkut Elbasan nuk është i protokolluar.

-Shkresa përcjellëse për Bashkinë Peqin për periudhën Korrik Dhjetor 2022 mbi verifikimin e bere ne këtë bashki mbanë nr. 65/1 date 13.01.2023 pra ne një dite me shkresën përcjellëse të programit. Akt verifikimi i datës 23.01.2023 për periudhën korrik dhjetor 2022 ne Bashkinë Peqin nuk është protokolluar dhe nuk është firmosur nga sekretari i këshillit Bashkiak të Peqinit.

Prefekti i qarkut Elbasan ka përcjell konkluzionet dhe rekomandimet e grupit te punës për verifikimin ne zbatimit te ligjshmërisë 10 dite para se te behej verifikimi ne vend ne Bashkinë Peqin, pasi programi i përcjell për verifikim n Bashkinë Peqin është me nr. 65 Prot., datë 13.01.2023.

Nga auditimi rezulton se:

Grupet e punës se ngritura për verifikimin ne terren te akteve normative te këshillave bashkiak dhe këshillit te qarkut Elbasan nuk kanë mbajtur Akt Konstatim sipas një formatit të miratuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, sipas parashikimeve të nenit 5 germa “e” mbi verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve ku parashikohet se:

Gjatë procesit të verifikimit në vend në institucionin e NJVV, grupi i punës mban një akt konstatimi, i cili nënshkruhet dhe nga përfaqësuesit e NJVV-së.

Për sa rezulton nga auditimi, me veprimet apo mosveprimet e strukturave përgjegjëse të institucionit të Prefektit të qarkut Elbasan mbi verifikimin në terren të ligjshmërisë së akteve normative pranë njërive të vet qeverisjes vendore, kanë qenë në mospërputhje me parashikimet e nenit 16 dhe 17 të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut ”dhe nenit 5/e aneksi 1 mbi Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, për këtë shkakë ngarkohen me përgjegjësi znj. A. G., Znj E. Z. në cilësinë e përfaqësuesve të prefekturës së qarkut Elbasan për verifikimin ne vend të ligjshmërisë në NJVQV, Z. A. G. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit Juridik dhe znj. M. P. në cilësinë e Prefektit të Qarkut Elbasan.

III. Verifikimi i akteve në terren për të cilat Prefekti nuk është shprehur mbi ligjshmërinë.

Nga auditimi rezulton se:

Referuar Akt konstatimeve/verifikimeve te mbajtura nga institucioni i prefektit te qarkut Elbasan për vitin 2022 nuk janë konstatuar akte me karakter normativ te padepozituara për verifikim ligjor tek Prefekti i Qarkut Elbasan.

IV. Auditimi i disa VKB-ve të vitit 2022 të përzgjedhur mbi bazë risku

1. Bashkia Peqin

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Peqin me Vendimin nr.7 date 07.03.2022 ka miratuar:

- 1.Listën e sipërfaqeve të fondit/kullosor qe do të jepen në përdorim me kontratë qeraje nëpërmjet procedurës së konkurrit publik
- 2.Sipërfaqet e fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Peqin do të jepen në përdorim vetëm për ushtrimin e veprimtarisë të parashikuar në legjislacionin në fuqi për pyjet dhe kullotat.
- 3.Verimtaritë do të ushtrohen në këto sipërfaqe pyjore/kullosore, do të jenë në përputhje me planet e tyre të mbarështimit

Në dokumentacionin qe shoqërojnë VKB drejtuar Prefektit të qarkut Elbasan, gjendet informacioni, e citoj si me poshtë:

“Kemi te dhëna se disa pjese te tyre janë zënë në mënyrë te paligjshme nga fermerë te ndryshëm, sipas informacioneve te sjella nga njësiti Administrative”

Nga auditimi rezulton se:

-Prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P. me shkresën nr.310/1 Prot., date 18.03.2022 ka konfirmuar këtë vendim si te bazuar dhe te mbështetur ne bazën ligjore ne fuqi.

-VKB nr. 7 date 07.03.2022 është protokolluar me date 10.03.2022 me nr. Prot. 310.

-Konfirmimi i aktit nga ana e prefektit mbanë nr.310/1 Prot. date 18.03.2022

-Baza ligjore e cituar ne VKB nr.7 date 07.03.2022 është e pasaktë, pasi ligji nr.9385 date 04.05.2005 “ Për pyjet dhe shërbimin pyjor” është shfuqizuar me ligjin nr.57/2020

-Këshilli Bashkiak nëpërmjet VKB nr.07. date 07.01.2022 në dokumentin shoqërues ka njoftuar Prefektin e Qarkut Elbasan që nga lista e fondit pyllor/kullosor qe do te jepen ne përdorim me kontrate qeraje nëpërmjet procedurës se konkurrimit publik, disa pjese te tyre janë zbatuar ne mënyrë te paligjshme.

-Prefekti i Qarkut znj. M. P. me shkresën Nr. 310/1 Prot. date 18.03.2022 ka konfirmuar në parim , mbështetjen e VKB nr.7 date 07.01.2022 si te mbështetur ne ligj.

-Ne pikëpamjen formale janë respektuar afatet kohore te parashikuara ne nenin 16, 17 te Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”;

-Prefekti i qarkut megjithëse është vendosur ne dijeni për zaptimin e tokave ka miratuar pa kërkuar informacion ne lidhje me zaptimin e disa pjesëve te këtij fondi pyllor/kullosor dhe nuk ka marre masa ne lidhje me këtë situatë duke vepruar ne mospërputhje me nenin 8 germa “g”, “gj”, “h” dhe nenin 10 pika 1 germa a, te Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”; ku parashikohet se:

Neni 8.

g) kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë;

gj) bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës;

h) shqyrtimin çdo muaj të veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave;

Neni 10

1. Për kryerjen e funksioneve në marrëdhënie me degët territoriale që veprojnë në qark, prefekti i qarkut ushtron përgjegjësitë e mëposhtme, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj:

a) kontrollon dhe kërkon marrjen e masave për zbatimin e programit të qeverisë, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e degës përkatëse;

Për sa më lart, me veprimet apo mos veprimet në mospërputhje me Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P.

2. Bashkia Elbasan

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan me Vendimin nr.18 date 04.03.2022 ka miratuar nisjen e procedurës për marrjen me qera te një mjeti transporti tip foristrade për plotësimin e nevojave te transportit te administratës se Bashkisë Elbasan, me një fond 75,000 lekë/muaj me afat 1 vjeçar. Bashkelidhur VKB nr.18 date 04.03.2022 është përcjell dhe relacioni i Këshillit Bashkiak Elbasan nr.1071 Prot. date 28.12.2022 “Mbi miratimin e nisjes se procedurës për marrjen me qira te një mjeti për plotësimin e nevojave te transportit te administratës se bashkisë Elbasan, me një fond deri 75000 leke/muaj

VKB nr.18 date 04.03.2022 sebashku me relacionin është përcjell institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën nr.1071/1 Prot. datë 04.03.2022.

Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.281/1 Prot. datë 09.03.2022 ka konfirmuar si të bazuar ne ligj VKB nr.18 datë 04.03.2022 “ Mbi miratimin e nisjes se procedurave për marrjen me qera

te një mjeti për plotësimin e nevojave të transportit të administratës së Bashkisë Elbasan me një fond deri 75,000 lekë/muaj.

Nga auditimi rezulton se:

VKB Nr.18 datë 04.03.2022, nuk ka referencë të bazës ligjore për marrjen me qera të mjetit. Relacioni shoqërues i Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.18 datë 04.03.2022 është i pa plotë dhe i pa mjaftueshëm në lidhje me të dhënat, si më poshtë.

-Kërkesa e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Elbasan, mbi nevojën e marrjes me qera të makinës tip foristrade,

-Numri i punonjësve të administratës, të cilët kanë nevojë për të përdorur mjetin e transportit,

-Metodologjia e përcaktimit të vlerës së qerasë mujore,

-Detyrimet mbi përfshirjen e shpenzime për karburant apo shërbime të mirëmbajtjes, etj.,

Referuar Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Aneksit 1 neni 4 pika 1 germa “b”, “c” dhe “d” mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, parashikohet se:

b. Akti i depozituar **duhet detyrimisht** të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

i. Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

ii. Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji;

iii. Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

iv. Projektvendim;

v. Certifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet;

vi. Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar);

vii. Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimmarrjes për emergjencat civile),

c. Në rast se, akti i paraqitur nuk është i shoqëruar nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë (i mësipërm), prefekti i qarkut ja kthen menjëherë aktin NJVV, duke e informuar se verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ do të bëhet vetëm pas paraqitjes së dokumentacionit.

d. **Prefekti i Qarkut ka të drejtë të kërkojë edhe dokumente të tjera, të cilat argumentojnë ligjshmërinë e vendimmarrjes sipas natyrës së vendimmarrjes.**

Për sa më lart, me veprimet apo mos veprimet në mospërputhje me Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P.

Nga auditimi me përzgjedhje të akteve të miratuara nga Këshillit Bashkiak Elbasan, të përcjella institucionit të prefektit të qarkut Elbasan, konstatohet se:

-VKB nr.162 date 30.11.2022 “ Për dhënien e fondit pyjor në përdorim” administruar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, me nr.1408 Prot., date 01.12.2022 dhe kthim përgjigje të prefektit të qarkut me shkresën 5575/3 Prot. date 19.12.2022

Baza ligjore:

Ligji nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”

Ligji nr.57 date 30.04.2020 “Për pyjet”

VKM 443 date 08.06.2016 “Për transferimi në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar

Ligji nr.8317 date 01.04.1998 “ për dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, ndryshuar

- VKM nr.559 date 29.07.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”

-VKM nr.559 date 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”

-Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “ Për rregullat, procedurat e kërkimit të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”

Këshilli Bashkiak me vendimin nr.162 date 30.11.2022 ka miratuar dhënien në përdorim të një sipërfaqe prej 8 Ha pyll për vendosjen e bazamenteve, stacioneve për panele fotovoltaike me qëllim prodhim energjie dhe 14.5 ha toke pyll për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje me një afat 9 vjeçar nga momenti i lidhjes së kontratës.

Vendimi i këshillit bashkiak është shoqëruar me relacionin nr.5575 port. date 25.11.2022 të drejtorisë së shërbimeve pyjore, bujqësore, veterinare dhe mjedisore të miratuar nga kryetari bashkisë Elbasan.

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1408/1 port. date 07.12.2022 “mbi ligjshmërinë e Aktit” ka kërkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

1 -Kopjen e listës së sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor të përgatitura nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat e bashkisë propozuar brenda muajit Janar të vitit vijues Kryetari të bashkisë të shoqëruar me një relacion të detajuar mbi mundësitë e përdorimit të tyre.

2- Kopjen e planit të përgjithshëm vendor dhe/ ose planin e detajuar vendor për zonën - objekt i aktit tuaj në 10 vitet e ardhshme.

3-Kopjen e hartës në shkallën 1:10000 ku të jete paraqitur sipërfaqja e fondit pyjor prej 22.5 ha (n/ngastrat 73/a dhe 74/a të Ekonomisë Pyjore Polis Vasjan) - objekt i aktit tuaj me kufij të përcaktuar qarte (koordinatat gjeografike, metrike).

4-Cila do të jete infrastruktura përkatëse e n/ngastrave në fjalë? A është parashikuar lidhja me rrugën kryesore e n/ngastrave në fjalë me hapjen apo ndërtimin e rrugëve dytësore, nëse është parashikuar a ekziston një projekt i tillë?

Nëse ekziston një projekt i tillë, të na vihet në dispozicion në kopje të tij. Nëse është parashikuar hapja apo ndërtimi i rrugëve lidhëse dytësore, kush do të investojë për hapjen apo ndërtimin e tyre, njësitë juaja të veteqeverisë vendore apo subjekti? Sa është sipërfaqja që zënë këto rrugë (gjatësia dhe gjerësia e tyre)?

Sa është sipërfaqja që zënë në këto n/ngastra stacionet, bazamentet për panelet fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë?

5 - Kopjen e raportit të plotësuar "Mbi studimin tekniko ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullësor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Elbasan" (shëno emërtimin e aktivitetit dhe të subjektit) të paraqitura nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat e bashkisë për shqyrtim dhe miratim nga Kryetari i Bashkisë, referuar përmbledhësës për dhënien e fondit pyjor në përdorim të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore/Bashkia Elbasan - bashkëlidhur aktit tuaj, të dërgoni kopjen e kërkesës së subjektit për marrjen e fondit pyjor në përdorim për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me fillim prodhim energjie (për nën ngastrën 74/a) si dhe kopjen e kërkesës së subjektit për marrjen e fondit pyjor në përdorim për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje (për nën ngastrën 73/a). 6 - Për çfarë jeni shprehur në faqen e tre të relacionit " Për dhënien e fondit pyjor në përdorim për "të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore/Bashkia Elbasan me shkresën e saj me Nr. 5575 Prot., date 25.11.2022 - bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e aktit tuaj, kërkojmë të na vini në dispozicion kopje të tyre pasi ato mungojnë, nuk i janë bashkëlidhur këtij relacioni. Deri në dërgimin e ketyre të dhënave, akti juaj mbetet i pa konfirmuar.

-Bashkia Elbasan në lidhje me kërkesat e paraqitura nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën 5575/3 Prot. datë 19.12.2022 me objekt “Kthim përgjigje” informon se bashkëlidhur

ka dërguar informacionin e kërkuar për pikat 1, 2, 3 dhe 4 të kërkesave respektive të paraqitura në shkresën e Prefektit të Qarkut Elbasan nr. Nr. 1408/1 Prot. date 07.12.2022.

Nga auditimi rezulton se:

-Bashkia Elbasan me shkresën nr. 5575/3 port date 19.12.2022 nuk ka përcjell dokumentacionin e plotë të kërkuar dhe të shprehur në 6 pikat e kërkesës, por është mjaftuar duke bashkëlidhur vetëm përshkrimin e njësisë strukturore 08/43 ku bën pjese kjo zonë si dhe hartën e zonës në shkallën e kërkuar, dhe për pikën 4 ka informuar se nuk është parashikuar ndërtim rrugësh sepse ka infrastrukturë rrugore ekzistuese.

-Megjithëse nga ana e Bashkisë Elbasan nuk u përcoll i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan të shprehura në pikën 5 dhe 6, në mungesë të tyre, Prefekti i Qarkut Elbasan ka konfirmuar aktin si të ligjshëm nëpërmjet shkresës nr.1408/3 Prot. datë 23.12.2022

Me veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Prefekti i Qarkut Elbasan Znj. M. P., z. F. D. me detyrë Specialist në Mbikëqyrjen e Mjedis, z. A. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, znj. L. B. me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme; dhe znj. A. G. me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik.

Këshilli Bashkiak i Elbasanit me vendimin nr.152 date 09.11.2022 ka miratuar dhënien në përdorim të një sipërfaqe prej 27 Ha në ngastrat nr.24/a, 25/cd dhe 26/ab ekonomi pyjore “Zalli Shkumbin” Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “H.” “I.” dhe “ ” për ndërtimin e impiantit regjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet 25 MW

Vendimi i Këshillit Bashkiak është shoqëruar me relacionin nr.5258 Prot. date 08.11.2022 të drejtorisë së shërbimeve pyjore, bujqësore, veterinarë dhe mjedisore të miratuar nga kryetari bashkisë Elbasan.

Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën Nr. 1334/1 Prot. date 11.11.2022 “mbi ligjshmërinë e Aktit” ka kërkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

1 -Kopjen e listës së sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor të përgatitura nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat e bashkisë propozuar brenda muajit Janar të vitit vijues Kryetari të bashkisë të shoqëruar me një relacion të detajuar mbi mundësitë e përdorimit të tyre.

2- Kopjen e planit të përgjithshëm vendor dhe/ ose planin e detajuar vendor për zonën - objekt i aktit tuaj në 10 vitet e ardhshme.

3-Kopjen e hartës në shkallën 1:10000 ku të jete paraqitur sipërfaqja e fondit pyjor prej 22.5 ha (n/ngastrat 73/a dhe 74/a të Ekonomisë Pyjore Polis Vasjan) - objekt i aktit tuaj me kufij të përcaktuar qarte (koordinatat gjeografike, metrike).

4-Cila do të jete infrastruktura përkatëse e n/ngastrave në fjalë? A është parashikuar lidhja me rrugën kryesore e n/ngastrave në fjalë me hapjen apo ndërtimin e rrugëve dytësore, nëse është parashikuar a ekziston një projekt i tillë?

Nëse ekziston një projekt i tillë, të na vihet në dispozicion në kopje të tij. Nëse është parashikuar hapja apo ndërtimi i rrugëve lidhëse dytësore, kush do të investojë për hapjen apo ndërtimin e tyre, njësitë juaja e vetëqeverisjes vendore apo subjekti? Sa është sipërfaqja që zënë këto rrugë (gjatësia dhe gjerësia e tyre)?

Sa është sipërfaqja që zënë në këto n/ngastra stacionet, bazamentet për panelet fotovoltaike me qellim prodhimin e energjisë?

5 - Kopjen e raportit të plotësuar "Mbi studimin teknik ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullësor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Elbasan" (shëno emërtimin e aktivitetit dhe të subjektit) të paraqitura nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat e bashkisë për shqyrtim dhe miratim nga Kryetari i Bashkisë, kopjen e miratimit paraprak nr.6849/3 date 02.11.2022 për vazhdimin e procedurave tekniko ligjore lëshuar nga (MIE) ministria e infrastrukturës dhe Energjisë si dhe kopjen e kërkesës të datës 03.11.2022 të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “H.” “P” dhe “L. d S.” përfaqësuar nga shoqëria “H.” me administrator z. S. H. për marrjen e fondit pyjor dhe kullësor publik në përdorim për ndërtimin e impiantit regjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike paraqitur njësisë tuaj të vetëqeverisjes vendore.

6 -Të dërgoni një përmbledhëse tjetër për dhënien e fondit pyjor në përdorim e cila të jetë e firmosur nga të tre përfaqësuesit e drejtorisë së shërbimeve pyjor, Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore/Bashkia Elbasan dhe e vulosur, deri në dërgimin e këtyre të dhënave, **akti juaj mbetet i pa konfirmuar.**

Bashkia Elbasan në lidhje me kërkesat e paraqitura nga institucioni i prefektit të qarkut Elbasan me shkresën 5258/3 Prot. date 19.12.2022 me objekt “Kthim përgjigje” informon se bashkëlidhur ka dërguar informacionin e kërkuar për pikat 1, 2, 3 dhe 4 të kërkesave respektive të paraqitura në shkresën e prefektit të qarkut Elbasan Nr. 1334/1 Prot. date 11.11.2022.

Nga auditimi rezulton se:

-Bashkia Elbasan me shkresën nr. 5258/3 Prot date 19.12.2022 nuk ka përcjell dokumentacionin e plotë të kërkuar për 6 pikat e kërkesës së prefektit Elbasan, por është mjaftuar duke bashkëlidhur vetëm përshkrimin e njësisë strukturore 05/24 ku bën pjesë kjo zonë si dhe hartën e zonës në shkallën e kërkuar dhe për piken 4 ka informuar se nuk është parashikuar ndërtim rrugësh sepse ka infrastruktur rrugore ekzistuese.

-Megjithëse nga ana e Bashkisë Elbasan nuk përcolli të gjithë dokumentacionin e kërkuar për piken 5, Prefekti i qarkut nëpërmjet shkresës 1334/3 Prot. datë 23.12.2022, në mungesë të të plotësimit tërësisht nga Bashkia Elbasan, ka konfirmuar aktin si të ligjshëm

Me veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. F. D. me detyrë Specialist në Mbikëqyrjen e Mjedis, z. A. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, znj. L. B. me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme dhe znj. A. G. me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik.

Nga auditimi me zgjedhje të miratimit të aktit nga ana e institucionit të prefektit të qarkut Elbasan me objekt “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuar nga djegia e banesës” konstatohet se:

I.Me vendimin nr. 32 date 04.03.2022 Këshilli i Qarkut Elbasan ka miratuar dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëme të shkaktuara nga djegia në banesën e shtetasit znj. X. P. në shumën 1,167,434 lekë për demin e shkaktuar nga djegia në banesën e saj.

-Referuar relacionit nr. 1112 Prot (pa date) të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore dhe Drejtoria e Emergjencave Civile pranë Bashkisë Elbasan për Këshillin Bashkiak të Bashkisë Elbasan:

Informon se më datë 17.01.2022 Drejtoria e Emergjencave Civile pranë Bashkisë Elbasan ka marrë informacion mbi djegien e banesës së Znj. X. P., banor në fshatin Xibrake njësie administrative Labinot fushe.

Në datë 20.01.2022 është mbajtur Proces verbali mbi demet e shkaktuara në banesën e kësaj shtetase nga Komisioni i ngarkuar me urdhrin nr. 487 Prot. date 29.06.2021, i cili ka bërë preventivin e dëmtimeve në masën përfundimtare në shumën 1,167,434 leke, sipas përcaktime të VKM nr.329, date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore”

-Institucioni i Prefektit me shkresën nr. 295/1 Prot. date 15.03.2022 “mbi ligjshmërinë e aktit tuaj” nuk e ka konfirmuar VKB nr. 32 date 04.03.2022 “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së Znj. X. P.” për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në VKM nr.329, date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore” deri në dërgimin e dokumentacionit të plotë.

-Me shkresën 1112/3 Prot. date 24.03.2022 Bashkia Elbasan, ka përcjell pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan dokumentacionin e mëposhtëm:

1.PV nga komisioni i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në objekt banimi në rast fatkeqësive natyrore.

2.Preventimin e vlerësimit të dëmeve të banesës së dëmtuar nga djegia

3.Preventivin e bazës materiale të djegur

4.Certifikatën për vërtetimin pronësie

5. Vërtetimin për rënien e zjarrit.

-Institucioni i prefektit të qarkut Elbasan nëpërmjet shkresës nr.295/3 Prot. date 01.04.2022 “konfirmim akti” sipas saj pas plotësimit dhe përcjelljes së dokumentacionit dhe verifikimit të tij dhe ligjmerisë së VKB nr.32. date 04.03.2022 ka konfirmuar këtë akt.

Nga auditimi rezulton se:

Proces verbal i mbajtur me datë 20.01.2022 nga anëtarët e komisionit të përbërë nga:

B. S., A. B., K. H., M. C. dhe E. H. kanë konstatuar se për sipërfaqen e objektit (shtëpi banimi 2 kate) me sip. objekti 101.7 m² janë djegur të gjitha orënditë që ndodheshin në katet respektive dhe dëmtim të sivatimeve të brendshme në masën 30%.

-Proces verbal është shoqëruar me dy foto të objektit nga pamja e jashtme.

-Nder të tjera në Proces Verbal është evidentuar djegia e 1 (një) sobe elektrike.

-Në relacionin e hartuar nga komisioni është përlllogaritur vlera totale e pajisjeve të identifikuar në proces verbal, dhe për pajisjen “Soba Elektrike” nga komisioni është përlllogaritur vlera e demit për dy cope soba elektrike.

-Drejtorja SHMZSH pranë bashkisë Elbasan me shkresën nr.04.prot date 13.01.2022 nëpërmjet vërtetimit nr.2 date 13.01.2022 “për rënien e zjarrit” për zjarrin e rënë në këtë banesë informon se zjarri ka rënë me datë 11.02.2022 ora 23:50.

-Në proces verbalin e komisionit të vlerësimit të dëmeve si datë e rënie të zjarrit përmendet data 17.01.2022

Në dokumentacionin e Bashkisë Elbasan nuk posedohet kërkesa e familjarëve për ndihmë financiare pranë Bashkisë Elbasan si dhe ka mos përputhje të datës së rënies së zjarrit nga komisioni për vlerësimin e demit dhe atij të MKZ të bashkisë Elbasan.

Për sa më lart, institucioni i prefektit ka vepruar në mospërputhje me parashikimet e nenit 16 të ligjit 107/2016 date 27.10.2016 “për prefektin e qarkut” dhe pikës 2 germa “f” kreu III (procedura në rastet kur nuk shpallet gjendje e emergjencës civile) të VKM nr.329, date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore të tjera të shkaktuar nga veprimtari njerëzore, duke ngarkuar me përgjegjësi znj. M. P. në cilësinë e prefektit të qarkut Elbasan, z A. G. në cilësinë e specialistes në sektorin juridik dhe z. E. G. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe krizave.

II. Me vendimin nr.33 date 04.03.2022 “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së Z. A. R., banor në “Lagjen Skënderbej” në Lagjen nr.3 si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan ka miratuar dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmet e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit Z.A. R. në shumën 86,620 lekë.

-Relacioni nr.1114 Prot. datë 28.02.2022 bashkelidhur vendimit nr.33 date 04.03.2022 të këshillit bashkiak të Bashkisë Elbasan i referohet ngjarjes së ndodhur me datë 17.01.2022 mbi djegien e banesës nga zjarri të shtetasit Z. R. P. banor në fshatin Xibrakë, njësi Administrative Labinot Fushë.

-Në relacion vlera e dëmeve në banesën e Z. R. P. është vlerësuar në shumën 322,829 leke dhe vlera e dëmeve të pajisjeve dhe orëndive në shumën 334,000 leke në total 656,829 leke

-Me shkresën nr.296/1 Prot. datë 15.03.2022 “Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj” prefekti i qarkut Elbasan nuk e ka konfirmuar aktin për shkaktim të mungesës së dokumentacionit.

Nga auditimi rezulton se:

Relacioni bashkelidhur VKB nr.33 date 04.03.2022 nuk përputhet me të dhënat e këtij vendimi si ne vlerën e dëmshpërblimit dhe të gjeneraliteteve të përfituesit.

Nga ana e strukturave përgjegjëse të prefektit të qarkut kjo mospërputhje nuk është evidentuar ne shkresën 296/1 Prot. date 15.03.2022.

III. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan me vendimin nr.34 date 04.03.2022 “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.R. P., banor në fshatin Xibrakë, Njësia Administrative “Labinot Fushë” si shpërblim financiar nga ana e bashkisë Elbasan” ka miratuar dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe vlerën **656,829 leke** për dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës.

-Bashkelidhur me VKB nr.34 date 04.03.2022 ne materialet e administruara nga grupi i auditimit të KLSH është relacioni nr.11113 (pa datë) që i referohet shtetasit Z.A. R. për vlerën e demit të shkaktuar nga djegia e banesës ne shumen 86620 leke

-Me shkresën nr.297/1 Prot. date 15.03.2022 “Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj” institucioni i prefektit të qarkut Elbasan për mos plotësim të dokumentacionit të parashikuar në VKM nr. 329 date 16.05.2012 “për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” nuk e ka konfirmuar aktin deri ne momentin e dërgimit të dokumentacionit.

-Me shkresën 1114/3 Prot. date 24.03.2022 Bashkia Elbasan ne përgjigje të kërkesës se prefektit të qarkut për plotësim dokumentacioni për VKB nr.34 date 04.03.2022 ka përcjell dokumentacionin si me poshtë vijon:

1.Proces verbalin e datës 20.01.2022 i mbajtur nga B. S., A. B., K. H., M. C., A. S.

Referuar Proces Verbalit të mbajtur nga komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara ne objektin e shtetasit Z.R. P. ne fshatin Xibrak, njësia administrative Labinot Fushe, zona kadastrale zk.3864, indeksi i hartës k-34-101-119-D, Bashkia Elbasan, sipërfaqja e objektit (shtëpi banimi 2 kate) është 55 m2

Sipas komisionit nga matjet e bëra me date 20.01.2022, është konstatuar se zjarri i rënë në objekt (shtëpi banimi), strukturë 2 katëshe ka shkrumbuar komplet ambientet e shtëpisë dykatëshe.

Proces verbali është shoqëruar dhe me foto të banesës se djegur të cilat janë të njëjta me fotografite e paraqitura ne proces verbalin e mbajtur nga komisioni i vlerësimit të dëmeve mbi bazën e të cilit është marre VKB nr.32. date 04.03.2022 i cili ka miratuar dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëme të shkaktuara nga djegia në banesën e shtetasit znj.X. P. në shumën 1,167,434 leke për demin e shkaktuar nga djegia në banesën e saj.

2.Vertetimi për rënien e zjarrit nr.05/1 Prot., date 13.01.2022 i Drejtorisë së SHMZSH, që sipas kësaj drejtorie me date 11.01.2022 rreth orës 23:50 ne fshatin Xibrak, njësia administrative Labinot Fushe, Bashkia Elbasan, ka rënë zjarr ne banesën dy kateshe ne pronësi të shtetasit R. P.

Me shkresën nr.297/3 Prot. date 31.03.2022 institucioni i prefektit të qarkut Elbasan ka konfirmuar Aktin.

Nga auditimi rezulton se:

Gjeneralitet e relacionit që shoqëron VKB nr. 34 date 04.03.2022 nuk përputhen me atë të VKB Proces verbal i datës 20.01.2022 i komisionit të vlerësimit të dëmeve ne banesën e djegur nga zjarri ka paraqitur fotografi të njëjta me ato të paraqitura ne proces verbalin e mbajtura nga komisioni i vlerësimit të dëmeve për shtetasen znj.X. P.

Proces verbali i datës 20.01.2022 nuk është firmosur nga pronari i banesës z.R. P.

Proces verbali i datës 20.01.2022 nuk është firmosur nga z.A. H. ne cilësinë e administratorit të njësies administrative “Labinot Fushe”

-Ne dokumentacioni e Bashkisë Elbasan nuk posedohet kërkesa e familjarëve për ndihmë financiare pranë Bashkisë Elbasan si dhe ka mos përputhje të datës së rënies së zjarrit nga komisioni për vlerësimin e demit dhe atij të MKZ të bashkisë Elbasan.

-Financimi për zhdëmtimin e dëmeve nga rënia e zjarrit në banesën e z. R. P. nga bashkia Elbasan është bere 2 here pasi të dhënat dhe adresa e ndërtesës së djegur janë të njëjta me shtetasen znj. X. P.

Për sa më lart, institucioni i prefektit ka vepruar në mospërputhje me parashikimet e nenit 16 të ligjit 107/2016 date 27.10.2016 “për prefektin e qarkut” dhe pikës 2 germa “f” kreu III (procedura në rastet kur nuk shpallet gjendje e emergjencës civile) të VKM nr.329, date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore të tjera të shkaktuar nga veprimtari njerëzore, duke ngarkuar me përgjegjësi znj. M. P. në cilësinë e prefektit të qarkut Elbasan, z A. G. në cilësinë e specialistes në sektorin juridik dhe z. E. G. në cilësinë e përgjegjës të sektorit të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe krizave.

3. Bashkia Librazhd

1. Këshilli Bashkiak Librazhd me Vendimin nr.16 date 28.02.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd” Bashkëlidhur VKB nr. 16 date 28.02.2022 është përcjell:

- proces-verbal nr. Ska, datë ska, i komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit i përbërë nga zj. S. O. ekonomiste me detyrë, përgjegjëse e sektorit të financës, zj. S. K. juriste me detyrë, përgjegjëse e sektorit juridik, z. C. V. me detyrë, përgjegjës i sektorit të punëve publike, zj. J. B. me detyrë, inxhinierë në sektorin e projekteve dhe z. B. H. me detyrë, teknik në sektorin e shërbimeve;
- përmbledhëse e pasqyrës së amortizimit për objektet jashtë përdorimit;
- relacion i datës 28.02.2024.

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 248/1 prot., datë 14.03.2022 me lëndë “Mbi ligjshmërinë e aktit” i ka kërkuar Këshillit Bashkiak Librazhd të dhëna plotësuese mbi procedurën e ndjekur për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve ndërtesë në pronësi të bashkisë, në zbatim të pikës 2, të udhëzimit nr. 11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Bashkia Librazhd me shkresën nr. 1781/1 prot datë 12.04.2022 i ka përcjell Prefekturës së qarkut Elbasan:

1. Urdhërin me nr. 503 datë 12.07.2021 “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e objekteve Magazina e Druve, Sera e Luleve nr. 1.2.3”.
2. Relacion Konstatimi të gjendjes fizike të objekteve me nr. Pasurie 8/68 dhe 8/69 zk. 2446 qyteti i Librazhdit.

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 248/3 Prot. date 13.06.2022 ka konfirmuar në parim si të bazuar në ligj Vendimin nr.16 date 28.02.2022 “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd”.

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 16 date 28.02.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 1781/1 prot datë 12.04.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Librazhd është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

-Mungon dokumentacioni pronësor i detyrueshëm i objekteve 1. Magazina e druve; 2. Sera e Luleve nr. 1; 3. Sera e Luleve nr. 2 dhe 4. Sera e Luleve nr. 3, ku ka si qëllim të vërtetojë faktin e regjistrimit të titullit të pronësisë apo të së drejtës reale, në bazë të nenit 17, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, në mungesë të tyre statusi juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet;

- Mungon mënyra e përfitimit të pasurive (Institucioni përgjegjës për administrim), nëse kanë ardhur si rezultat i transferimit nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë vendore referuar dispozitave të ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në

njësitë e qeverisjes vendore” (Miratimi nga Këshillit i Ministrave, së bashku me dokumentacionin përkatës)

Gjithashtu mungojnë arsyet e nxjerrjes nga përdorimi, vlerësimet e ekspertit të fushës si dhe metoda që propozohet për daljen nga përdorimi referuar udhëzimit nr. 11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Megjithëse nga ana e Bashkisë Librazhd nuk u përcoll i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga prefekti i qarkut Elbasan nëpërmjet shkresës . 248/1 prot., datë 14.03.2022 edhe në mungesë të dokumentacionit të kërkuar dhe të pa plotësuar tërësisht nga Bashkia Librazhd, prefekti i qarkut Elbasan me shkresën 248/3 datë 13.06.2022 ka konfirmuar aktin “Në parim si të bazuar në ligj” në kundërshtim me ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P. z. G. U. me detyrë specialiste pran sektorit urban, znj. A. Z. me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, znj. E. Z. me detyrë ish/specialiste e sektorit juridik. dhe znj. L. B. me detyrë ish/Sekretare e Përgjithshme.

2. Këshilli Bashkiak Librazhd me Vendimin nr. 67 date 29.07.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd” Bashkëlidhur VKB nr. 67 date 29.07.2022 është përcjell:

- relacioni i vlerësimit të objektit;

- procesverbali me tabelën e amortizimit

- Kërkesë për ndërhyrje urgjente në Shkollën 9-vjecare Mirake Plane drejtuar Bashkisë Librazhd nga drejtori i shkollës z. M. T.

- urdhër nr. 697/4 datë 26.11.2019 “Për ngritjen e komisionit për verifikimin dhe konstatimin e dëmeve të shaktuara nga fatkeqësia natyrore (Rënie Tërmeti) në shtëpi banimi objekte shtetërore dhe private në territorin e Bashkisë Librazhd”.

- Relacioni i datës 29.07.2022 i Këshillit Bashkiakë.

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 938/1 Prot. date 09.08.2022 ka konfirmuar në parim mbështetjen e tij në ligj, Vendimin nr.67 date 29.07.2022 “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd”.

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 67 date 29.07.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 3590/5 prot., datë 01.08.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Librazhd është i pamjaftueshëm për tu shprehur “në parim mbështetjen e tij në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm i përcaktuar në aneksin nr. 1 referuar udhëzimit nr. 11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Gjithashtu mungon dokumentacioni pronësor i detyrueshëm i objektit “Shkolla Mirake – Plane” ku ka si qëllim të vërtetojë faktin e regjistrimit të titullit të pronësisë apo të së drejtës reale, në bazë të nenit 17, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, në mungesë të tyre statusi juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet;

- Mungon mënyra e përfitimit të pasurive (Institucioni përgjegjës për administrim), nëse kanë ardhur si rezultat i transferimit nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë vendore referuar dispozitave të ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (Miratimi nga Këshillit i Ministrave, së bashku me dokumentacionin përkatës)

- Megjithëse nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, prefekti i qarkut Elbasan me shkresën 938/1 prot., datë 09.08.2022 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P.

3. Këshilli Bashkiak Librazhd me Vendimin nr. 85 date 30.09.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik “Zgjerimi i Miniparkut të Qerëshive + Ndërtimi i Vendëparkimit për automjetet” zk. 2446 nga Bashkia Librazhd dhe burimi i financimit të këtij projekti shpronësimi” Bashkëlidhur VKB nr. 85 date 30.09.2022 është përcjell:

- Relacion i paraqitur nga bashkia Librazhd “Mbi Miratimin në parim fillimin e procedurës për shpronësim.

- relacionin e datës 30.09.2022 të këshillit bashkiak Librazhd.

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 1194/1 Prot. date 11.10.2022 ka konfirmuar në parim mbështetjen e tij në ligj, Vendimin nr.85 date 30.09.2022 “Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik “Zgjerimi i Miniparkut të Qerëshive + Ndërtimi i Vendëparkimit për automjetet” zk. 2446 nga Bashkia Librazhd dhe burimi i financimit të këtij projekti shpronësimi”.

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 85 date 30.09.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 4459/12 prot datë 04.10.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Librazhd është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

- Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

- Projektvendim;

- Statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet e pasurive të cilat preken nga projekti i “Zgjerimi i Miniparkut të Qerëshive + Ndërtimi i Vendëparkimit për automjetet” zk. 2446 nga Bashkia Librazhd dhe burimi i financimit të këtij projekti shpronësimi”;

- Certifikata e pransisë e personave të cituar në VKB nr. 85 date 30.09.2022, respektivisht; . 1. Z. K. K. dhe 2. z F. B.;

- Urdhrin për komisionin e posaçëm nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimit, për ndjekjen dhe realizimin e procedura të shpronësimit;

- Akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë Librazhd;

- Mungon përllogaritja e shpronësimit për z. K. K. dhe z F. B. në zbatim të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private në interes publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret e vlerësimit dhe përllogaritjes të masës të shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtat e personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar me VKM nr. 395, datë 13.05.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASHSH”.

Megjithëse nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, prefekti i qarkut Elbasan me shkresën 1194/1 prot., datë 11.10.2022 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. A. K. me detyrë përgjegjës i sektorit të zhvillimit urban, znj. L. B. me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme, z. A. G. me detyrë përgjegjës i sektorit juridik.

4. Këshilli Bashkiak Librazhd me Vendimin nr. 23 date 29.03.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Për prishjen e Objektit Ish Komisiariati i Policisë Librazhd”. Bashkëlidhur VKB nr. 23 date 29.03.2022 është përcjell:

- Kërkesa për prishjen e objektit drejtuar këshillit bashkiak Librazhd;

- Plan Rilevimi përgatitur nga zyra e urbanistikës;

- Relacionin e datës 29.03.2022 të K.B Librazhd

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr. 459/1 Prot. date 08.04.2022 ka konfirmuar në parim mbështetjen e tij në ligj, Vendimin nr. 23 date 29.03.2022 “Për prishjen e Objektit Ish Komisiariati i Policisë Librazhd”.

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 23 date 29.03.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 1663/4 prot datë 05.04.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Librazhd është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

- VKM nr. 732 datë 03.12.2021 mbi “Transferimin në pronësi nga Ministria e Brendshme të Bashkia Librazhd të një pjese të pasurisë 7/136 me emërtimin “Komisariat i Policisë Librazhd” me sipërfaqe trualli 1900 m² dhe me sipërfaqe ndërtese 513 m², me vendndodhje zk. 2446, referuar dispozitave të ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (Miratimi nga Këshilli i Ministrave, së bashku me dokumentacionin përkatës)

- mungon dokumentacioni pronësor i detyrueshëm i objektit “Komisariat i Policisë Librazhd”;
- Statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet e pasurive të cilat preken nga projekti i “Ndërtimit të Central Parkut (Parku i Qershive)”;

- mungon dokumentacioni i detyrueshëm i “Nxjerrjes nga përdorimi i ndërtesave” sipas pikës 118/2 germa “d”; referuar udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar

-Megjithëse nga ana e Bashkisë Librazhd nuk u përcoll i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga prefekti i qarkut Elbasan nëpërmjet shkresës nr. 1663/1 prot., datë 05.04.2022 edhe në mungesë të dokumentacionit të kërkuar dhe të pa plotësuar tërësisht nga Bashkia Librazhd, prefekti i qarkut Elbasan me shkresën 459/1 prot., datë 08.04.2022 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim me ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P. znj. G. T. ish/specialiste e sektorit të zhvillimit urban z. A. K. me detyrë përgjegjëse i sektorit të zhvillimit urban, znj. E. Z..

5. Këshilli Bashkiak Librazhd me Vendimin nr. 91 date 28.10.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit dhe prishjen të objektit nr. 2 dhe 3 me numër pasurie 755 me emërtimin ish grup depo” me vendndodhje Murrash Librazhd. Bashkëlidhur VKB nr. 91 date 28.10.2022 është përcjell:

- Urdhëri i nr. 771 datë 03.10.2022 “Për krijimin e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të objektit nr. 2 dhe 3 me numër pasurie 755 me emërtimin ish grup depo” me vendndodhje Murrash Librazhd;

- proces-verbal nr. Ska, datë ska, i komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit;

- Urdhëri i Ministrit të Mbrotjtjes nr. 1059 datë 14.07.2022;

- Procesverbal i përbashkët i dorisimit nga Reparti Ushtarak me nr. 4006 me nr. 363/1 regj. datë 25.07.2022 dhe protokolluar në Bashkinë Librazhd me nr. 3419 regj date 25.07.2022.

VKM nr 414 datë 15.06.2022 “Për transferimin në pronësi nga Ministria e Mbrotjtjes të pronës nr 755 me emërtimin ish grup depo” me vendndodhje Murrash Librazhd zona kadastrale 2696;

- Plan Rilevimi për punime kadastrale;

- 1 foto

- Flet dalje nga magazina së bashku me vlerën përkatëse;

- Relacion i datës 28.10.2022 i Këshillit Bashkiak Librazhd.

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 91 date 28.10.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 4905/4 prot datë 31.10.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Librazhd është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

- mungon dokumentacioni i detyrueshëm i “Nxjerrjes nga përdorimi i ndërtesave” sipas pikave 118.1 dhe 118.2 gërma “a” dhe “d”; referuar udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar

Megjithëse nga ana e Këshillit Bashkiak Librazhd nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, prefekti i qarkut Elbasan me shkresën 4905/4 prot., datë 31.10.2022 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. A. K. me detyrë përgjegjësi i sektorit të zhvillimit urban, znj. L. B. me detyrë ish/Sekretare e Përgjithshme, z. A. G. me detyrë përgjegjësi i Sektorit Juridik.

6. Këshilli Bashkiak Librazhd me Vendimin nr. 51 date 31.05.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Për miratimin e hapjes së rrugës auto në fondin pyjor/kullosor”. Bashkëlidhur VKB nr. 51 date 31.05.2022 është përcjell:

- Relacion “Për miratimin e hapjes së rrugës auto në fondin pyjor/kullosor”;

-Fragment harte e marrë nga Asig;

- Relacion i datës 31.05.2022 i Këshillit Bashkiak Librazhd;

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën Nr. 721/1 port. date 16.06.2022 “Mbi ligjshmërinë e Aktit” ka kërkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

1. A ka projekt për hapjen e kësaj rruge? Nëse ka, të na vihet në dispozicion një kopje e tij.

2. Cilat janë përmasat e rrugës (gjatësia dhe gjerësia) dhe sa është sipërfaqja totale që zë rruga pasi referuar ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet” neni 4 Kufijt dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar pika 4 dhe 8, ndryshuar (Heqja/shtesa) e sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

a- Miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;

b-VKM për sipërfaqe nga 1 deri në 10 ha;

c- me ligj të vecant për sipërfaqe mbi 10 ha;

dhe se ndryshimet në sipërfaqe, destinacion dhe çdo element që lidhet me të, duhet të pasqyrohen në regjistrin kombëtar të fondit pyjor pas miratimit nga organi kompetent.

3. Cila është shkalla e hartës bashkëlidhur aktit tuaj;

4. Rruga që kërkohet të hapet – objekt i aktit tuaj, në cilën zonë kadastrale përfshihet, në cilën ekonomi pyjore, njësi administrative dhe në cilën fshat ndodhet ajo për të cilin ju keni vendosur hapjen e saj?

5. Për mbulimin e shpenzimeve që do të bëhen për hapjen e rrugës, kush do të jetë investitori i saj (Bashkia Librazhd apo shtetas)?

6. Hapja e kësaj rruge a prek pronë private?

Deri në dërgimin e ketyre të dhënave, **akti juaj mbetet i pa konfirmuar.**

-Bashkia Librazhd në lidhje me kërkesat e paraqitura nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan me shkresën 4056 Prot. date 14.09.2022 me objekt “Kthim përgjigje” informon se bashkëlidhur ka dërguar informacionin e kërkuar për pikat 1, 2, 3 dhe 4 të kërkesave respektive të paraqitura në shkresën e prefektit të qarkut Elbasan nr. Nr. 1408/1 Prot. date 07.12.2022.

Nga auditimi konstatohet se:

-Bashkia Librazhd me shkresën nr. 4056 Prot. date 14.09.2022 nuk ka përcjell dokumentacionin e plote të kërkuar dhe të shprehur në 6 pikat e kërkesës, Bashkia ka bashkëlidhur Projekt Zbatimin me emërtimin “Ndërtim Rruge në pronën e z. I. B., Fshati Dragostunjë, Njësia Qëndër, Bashkia Librazhd”, preventivin e miratua, Hartën e rrugës në shkallën 1 : 5000. Referuar zonës kadastrale 1527 në ekonominë pyjore Librazhd, Njësia Qëndër, Fshati Dragostunjë nuk është parashikuar njësia strukturore ku bën pjese kjo zonë si dhe hartën e zonës në shkallën e kërkuar dhe për piken 3 ka informuar se nuk është parashikuar ndërtim rrugësh.

Gjithashtu nuk është vërtetuar marrëdhënia juridikë ndërmjet Bashkisë Librazhd dhe z. I. B., pasi referuar projektit të zbatimit është cilësuar “Pronar” si dhe nuk është paraqitur ndonjë dokument nga ASHK për të vërtetuar statusin juridik të pronës sipas gjurmës që prek projekti i zbatimit.

-Megjithëse nga ana e bashkisë Librazhd nuk u përcoll i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga prefekti i qarkut Elbasan të shprehura në piken 2 dhe 6, Prefekti i qarkut në mungesë të tyre, ka konfirmuar aktin si të ligjshëm nëpërmjet shkresës nr. 721/3 Prot. datë 20.09.2022.

Me veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. A. K. me detyrë përgjegjës i sektorit të zhvillimit urban, znj. L. B. me detyrë ish/Sekretare e Përgjithshme, dhe z. A. G. me detyrë përgjegjësi i sektorit juridik.

7. Këshilli Bashkiak Librazhd me Vendimin nr. 84 date 04.10.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Për përdorim të sipërfaqes për zhvillimin e Blektorisë”. Bashkëlidhur VKB nr. 84 date 31.05.2022 është përcjell:

- Relacion mbi Projekt Vendimin “Për dhënien në përdorim të sipërfaqes për zhvillimin e Blektorisë”.

- relacioni i datës 30.09.2022 i Këshillit Bashkiak Librazhd.

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 84 date 04.10.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 4459/11 prot datë 04.10.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Librazhd është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

- Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore;

- Certifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet;

- *Kopjen e listës së sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullësor të përgatitura nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat e bashkisë propozuar brenda muajit janar të vitit vijues Kryetari të bashkisë të shoqëruar me një relacion të detajuar mbi mundësitë e përdorimit të tyre.*

- Kopjen e raportit të plotësuar “Mbi studimin tekniko ekonomik për dhënie në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullësor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Librazhd” të paraqitura nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat e bashkisë për shqyrtim dhe miratim nga Kryetari i Bashkisë për sipërfaqen 0.2 ha në ngastrën nr. 145 a të ekonomisë pyjore Librazhd.

Megjithëse nga ana e Këshillit Bashkiak Librazhd nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën 1193/1 prot., datë 14.10.2022 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. F. D. me detyrë specialis në mbyqurjen e mjedisi, z. A. K. me detyrë përgjegjës i sektorit të zhvillimit urban, znj. L. B. me detyrë ish/Sekretare e Përgjithshme, znj. A. G. me detyrë specjaliste pranë Sektorit Juridik.

4. Bashkia Prrenjas

1. Këshilli Bashkiak Prrenjas me Vendimin nr. 68 date 19.08.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Për miratimin e ndryshim funksioni të objektit ish magazina e Rezervave të shtetit në palestër për shkollën Ahmet Elezi Stravaj”. Bashkëlidhur VKB nr. 68 date 19.08.2022 është përcjell:

- Relacioni i firmosur nga zj. D. Ç. dhe z. A. B.

-Projekt vendimin i firmosur nga Kryetari i Bashkisë z. N. B.

- Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 68 date 09.08.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 2290 prot., datë 19.08.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Prrenjas është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

- Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore
- Certifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet, ku ka si qëllim të vërtetojë faktin e regjistrimit të titullit të pronësisë apo të së drejtës reale, në bazë të nenit 17, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”,
- Mungon leja për ndryshimin e aktiviteteve dhe funksioneve të njësive individuale e cila jepet nga Autoriteti i zhvillimit me kusht mosndryshimin e sistemit konstruktiv, në bazë të përputhshmërisë me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës të përcaktuara nga PPV-ja ose PDV-ja e cila miratohet në sistemin e-leje sipas VKM nr. Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” me ndryshime;
- Mungom mënyra e përfitimit të pasurive (Institucioni përgjegjës për administrim), nëse kanë ardhur si rezultat i transferimit nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë vendore referuar dispozitave të ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (Miratimi nga Këshillit i Ministrave, së bashku me dokumentacionin përkatës)
- Preventivi i punimeve.

Megjithëse nga ana e Këshillit Bashkiak Prrenjas nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën 996/1 prot., datë 24.08.2022 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. A. K. me detyrë përgjegjës i sektorit të zhvillimit urban, znj. L. B. me detyrë ish sekretare e përgjithshme dhe znj. E. Z. me detyrë ish/specialiste e sektorit juridik.

V. Verifikimin e ligjshmërisë (bazës ligjore etj.) për rastet kur është dhënë mendim negativ (kundërshtues).

Bazuar në nenin 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan është verifikuar ligjshmëria e akteve me karakter normativ të depozituara në pranë këtij institucionit nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Për vitin 2022 janë depozituar gjithsej - 763 akte, dhe për vitin 2022 janë kthyer si të pabazuar në ligj plotësisht 7 akte.

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se:

-Bashkia Prrenjas ka miratuar aktin nr.13 datë 28.02.2022 “Miratimin e listës së familjeve që plotësojnë kushtet për grand të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët për vitin 2022”, dhe nga verifikimi i këtij akti dhe dokumentacioneve bashkëngjitur tij rezulton se bie në kundërshtim me ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, pasi grandit i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga i cili përfitojnë familjet të cilat kanë në përbërje një person me aftësi të kufizuar është në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët, përcaktim ligjor ky që nuk është respektuar pasi vlera e grandit për familjen përfituese është më e madhe se 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

Akti është kthyer nga institucioni i prefektit të qarkut Elbasan si i pabazuar në ligj, vendimi i këshillit bashkiak ka qenë i gabuar në këtë vendimmarrje

-Bashkia Prrenjas ka miratuar aktin nr.27 datë 04.05.2022 “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga zjarri në lokalit të z. A. K.”, dhe nga verifikimi i këtij akti dhe dokumentacioneve bashkëngjitur tij rezulton se bie në kundërshtim me VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, pasi dokumentacionet e dosjes përkatëse të cilat pasqyrojnë fatkeqësinë e ndodhur nuk kanë qenë të plota sipas VKM-së së sipërcituar si dhe klasifikimi ose mos përfshirja e kriterëve

sipas akteve ligjore e bën të pamundur dhe të pazbatueshëm këtë akt. Akti është kthyer si i pabazuar në ligj pasi vullneti i këshillit bashkiak ka qenë plotësisht i gabuar në lidhje me përcaktimin në vendimmarrje.

-Bashkia Prrenjas ka miratuar aktin nr.69 datë 28.09.2022 “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga zjarri në magazinë e kasollen e z. X. K.”, dhe nga verifikimi i këtij akti dhe dokumentacioneve bashkëngjitur tij rezulton se bie në kundërshtim me VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, pasi objektet si magazinë dhe kasolle nuk përfshihen për tu dëmshpërblyer sipas VKM-së së sipërcituar si dhe klasifikimi ose mos përfshirja e kriterëve sipas akteve ligjore e bën të pamundur dhe të pazbatueshëm këtë akt. Akti është kthyer si i pabazuar në ligj pasi vullneti i këshillit bashkiak ka qenë plotësisht i gabuar në lidhje me përcaktimin në vendimmarrje.

-Bashkia Prrenjas ka miratuar aktin nr.104 datë 30.11.2022 “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga zjarri në mullarët e z.X. D.”, dhe nga verifikimi i këtij akti dhe dokumentacioneve bashkëngjitur tij rezulton se bie në kundërshtim me VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, pasi objektet si mullarët nuk përfshihen për tu dëmshpërblyer sipas VKM-së së sipërcituar si dhe klasifikimi ose mos përfshirja e kriterëve sipas akteve ligjore e bën të pamundur dhe të pazbatueshëm këtë akt. Akti është kthyer si i pabazuar në ligj pasi vullneti i këshillit bashkiak ka qenë plotësisht i gabuar në lidhje me përcaktimin në vendimmarrje.

- Bashkia Belsh ka miratuar aktin nr.14 datë 22.02.2022 “Për krijimin e njësisë administrative nr.5 Belsh”, dhe nga verifikimi i këtij akti dhe dokumentacioneve bashkëngjitur tij rezulton se bie në kundërshtim me ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, miratuar në datë 17.12.2015, pasi njësitë administrative si nënndarje e bashkive përcaktohen me ligj si rrjedhojë organi kompetent për miratimin e shtrirjes territoriale dhe emërtimin e tyre është ligjvënësi, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, sipas procedurave ligjore, përcaktim ligjor ky që nuk është respektuar dhe është keqinterpretuar nga ana e këshillit bashkiak. Këshilli Bashkiak në respekt të ligjit për vetëqeverisjen vendore mund të përcaktojë vetëm ndarjen në lagje të qyteteve dhe jo më shumë. Akti është kthyer si i pabazuar në ligj pasi vullneti i këshillit bashkiak ka qenë plotësisht i gabuar në lidhje me përcaktimin në vendimmarrje.

- Bashkia Gramsh ka miratuar aktin nr.5 datë 28.01.2022 “Për një ndryshim të vendimit nr.132 date 29.12.2021 për bursat”, dhe nga verifikimi i këtij akti dhe dokumentacioneve bashkëngjitur tij rezulton se bie në kundërshtim me VKM nr.666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit para universitar në institucionet arsimore publike”, pasi afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave është muaji Dhjetor, vendim i cili është miratuar në muajin Janar përtej këtij afati, si dhe nuk ka një urdhër të Ministrit përgjegjës që të lejonte ndryshimet ose miratimin përtej afatit të përcaktuar me ligj, përcaktim ligjor ky që nuk është respektuar dhe është keqinterpretuar nga ana e këshillit bashkiak. Akti është kthyer si i pabazuar në ligj pasi vullneti i këshillit bashkiak ka qenë plotësisht i gabuar dhe përtej afateve ligjore në lidhje me përcaktimin në vendimmarrje.

- Bashkia Gramsh ka miratuar aktin nr.77 datë 30.09.2022 “Për trajtimin financiar të dëmeve të shkaktuara nga zjarri në magazinën e z. B. K.”, dhe nga verifikimi i këtij akti dhe dokumentacioneve bashkëngjitur tij rezulton se bie në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” me të gjitha ndryshimet dhe Udhëzimin

nr.26 datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, me të gjitha ndryshimet, pasi situata dhe gjendja financiare e bashkisë në lidhje me llogarinë financiare të Fondit Rezervë nga ku do të bëhej ky trajtim financiar sipas klasifikimit në këtë vendim ishte e pamundur dhe në këto kushte nuk duhej të ishte marrë fare si iniciativë ligjore nga ana e këshillit bashkiak. Akti është kthyer si i pabazuar në ligj pasi vullneti i këshillit bashkiak ka qenë plotësisht i gabuar në lidhje me përcaktimin në vendimmarrje.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ, duke mos përfshirë aktet me karakter individual etj.

Nga auditimi i dokumentacionit te vendosur ne dispozicion, konstatohet se:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, kryesisht Këshillat depozitojnë akte të çdo natyre, në disa raste edhe organe të tjera vendore ose qendrore kërkojnë shprehjen e Prefektit mbi aktin (si një kontroll paraprak) para vazhdimin me procedurat përkatëse, prefekti është shprehur në lidhje me aktet e depozituara, por institucioni i prefektit te qarkut duhet te bej klasifikimin e akteve me karakter individual, kolektiv dhe normativ.

VI. Mbi pavlefshmërinë e akteve në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

Bazuar në shkresën nr.674/1 Prot date 18.06.2024 “Informacion mbi rastet e kërkuara për pavlefshmëri të akteve në gjykate pasi dhe mbi aktet e kthyera si te pabazuara ne ligj” nga institucioni i prefektit te qarkut Elbasan për periudhën objekt auditimi, konstatohet se nuk është kërkuar pavlefshmëri të akteve në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, rezulton se janë depozituar pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan 650 akte, nga të cilat janë konfirmuar si të bazuara në ligj 612 akte dhe janë kthyer si të pa bazuara në ligj 38 akte. Nuk ka asnjë akt të dërguar në gjykatë.

-Lidhur me dosjet e praktikova (akteve), rezultojnë të gjitha të pa inventarizuar, pa numerizuar dhe pa arkivuar, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*, neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH”, neni 8 germa (g) ku citohet se:

“...Organizimi i brendshëm i dosjes (sistemin) përfshin renditjen e dokumenteve brenda dosjes sipas disa kriterëve që janë të njëjta me ato të krijimit të njësisë së ruajtjes. Kriteri i objektit përdoret kur dosja është krijuar me koncept të gjerë dhe dokumentet grupohen me nënçështjeje. Kur volumi i dokumenteve është i konsiderueshëm dhe ka të bëjë me emra personash, përdoret edhe kriteri alfabetik, më pas bëhet numërimi i dokumenteve. Të gjitha fletët e dosjes (përveç fletëve të bardha) numërohen me laps të zi grafiti në këndin e djathtë, pa cenuar tekstin”.

Sipas njësive vendore për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, vendimet (aktet normative) të hyra në Institucionin e Prefektit dhe të shqyrtuara, paraqiten të detajuara si më poshtë:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

Nr	Njësi Qeverisjes Vendore	Akte të ardhura	Të bazuara në ligj (të konfirmuara)	Të pabazuara në ligj (të kthyera)	Dërguar në Gjykatë
1	Këshilli i Qarkut	43	43	-	-
2	Bashkia Elbasan	110	102	8	-
3	Bashkia Belsh	57	49	8	-
4	Bashkia Cërrik	80	78	2	-
5	Bashkia Librazhd	104	94	10	-
-	Bashkia Përrenjas	91	88	3	-
7	Bashkia Gramsh	84	79	5	-
8	Bashkia Peqin	81	79	2	-
	Total	650	612	38	-

1.Bashkia Gramsh

Nga auditimi për vendimet e administruara, konfirmuara dhe kthyer nga Bashkia Gramsh, rezultoi si vijon:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, në Prefekturën e Qarkut Elbasan janë administruar 84 vendime për konfirmim akti.

Lidhur me administrimin dhe trajtimin e vendimeve të administruara pranë Prefekturës, në të gjitha rastet nga pikëpamja formale është bërë hyrja në protokollin e institucionit, duke u sigluar data e hyrjes. Është bërë kalimi i shkresës më shënimin përkatës për sektorin i cili do bëjë trajtimin e saj sipas specifikës së vendimit. Shqyrtimi i aktit dhe konfirmimi, refuzimi apo kthimi i tij me shënimet përkatëse, është bërë në të gjitha rastet brenda afatit 10 ditë nga data e regjistrimit, në përputhje me nenin 16, pika 1 germa (b) “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” të ligjit me nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

-Në aktin e konfirmimit, konstatohet se në thuajse të gjitha rastet mungon një relacion nga punonjësit e ngarkuar për shqyrtimin e aktit.

-Nga verifikimi i akteve të administruara për shqyrtim vlefshmërie, konstatohet se në 28 raste ose 33% e vendimeve të Këshillit Bashkiak, vendimet janë për dhënie ndihme për arsye shëndetësore dhe për shpenzime varrimi të personave në vështirësi financiare. Lidhur me konfirmimin e këtyre vendimeve, audituesit sqarojnë se krahas mungesës së relacionit i cili duhet të ishte pjesë e dokumentacionit përpara konfirmimit nga Prefekti, në të gjitha rastet legjislacioni i cituar në vendimmarrjen e këshillit nuk është i plotë, ndërkohë që edhe konfirmimi nga Prefekti nuk ka të përcaktuar bazueshmërinë ligjore. Gjithashtu, Këshilli i Bashkisë së Gramshit, nuk ka të përcaktuar kriteret se si do aplikohet fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve për kurim apo shpenzimet e varrimit, duke mos evidentuar target grupin i cili do jetë përfitues i këtij fondi.

-U verifikua konfirmimi i vendimit të Këshillit Bashkiak Gramsh me nr. 49, datë 30.06.2023 “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit S. M., banor lagjja “Sporti 1”, bashkia Gramsh, si dhe dëmshpërblimin financiar të kësaj familje”. Konfirmimi i aktit nga Prefekti është bërë me shkresën nr. 780/1 prot., datë 12.07.2023, brenda afatit ligjor. Sipas këtij vendimi, sqarohet se përlllogaritja e vlerës 1,681,580 lekë është bërë bazuar në VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

-Nga përlllogaritjet e bëra nga komisioni i ngritur sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, rezulton se janë përlllogaritur dëmet në vlerën 409,900 lekë për orenditë shtëpiake dhe punime ndërtimore në vlerën 2,543,359 lekë.

Lidhur me orenditë shtëpiake, sipas komisionit janë bazuar në pikën 2 germa (e) të VKM-së së cituar më sipër, e cila përcakton se *Vlerësimi për orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake të dëmtuara në objektet e banimit bëhet mbi bazën e çmimeve aktuale mesatare, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dërguar me shkresën zyrtare këshillit të qarkut përkatës.* Sipas komisionit përlllogaritja e mësipërme është bërë bazuar në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan me nr. 2382, datë 30.09.2016 si dhe nr. 5319/1 prot.,m datë 13.05.2016.

Lidhur me këto shkresa të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan, audituesit sqarojnë se kemi të bëjmë me shkresa të pa përditësuara, pasi kanë kaluar 7 vite nga kjo shkresë, dhe treguesit e çmimeve kanë ndryshuar, ku referuar tregut ato janë më të larta, dhe sa më sipër kemi të bëjmë me vlera jo reale mobiliimi, duke mos u dhënë ndihma konkrete në vlerë monetare në raport me dëmin e shkaktuar. Prefekti i Qarkut Elbasan, personat për trajtimin e kë këtij vendimi, kanë detyrimin të vlerësojnë përputhjen e plotë të këtij vendimi, dhe të paraqesin me relacionin përkatës qëndrimin

e tyre, ku të evidentohet gjithashtu fakti që shkresa me të cilën bazohet përlllogaritja e orendive është e papërditësuar dhe nuk përputhet me gjendjen aktuale të tregut.

-Nga përlllogaritja e preventivit të punimeve, ka rezultuar vlera e punimeve 2,543,359 lekë. Sipas pikës 3, germa (ç) të VKM-së së cituar më sipër, përcaktohet se *Masa e ndihmës financiare për dëmtimet individuale ose në grupe të vogla të banesave jepet nga Ministria e Brendshme ose njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet fondit të miratuar në buxhetin e vitit në programin "Emergjencat Civile". Ajo do të llogaritet në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në shkronjat (b) dhe (c) të kësaj pike dhe do të jetë 50% e vlerës së llogaritur.*

Në germën (b) të nenit të mësipërm, përcaktohet se *Masa e ndihmës bazohet në preventivin e bërë nga grupet e vlerësimit, llogaritur me çmimet në fuqi, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave....*

Sa më sipër, rezulton se për punimet e ndërtimit, është miratuar vlera 1,271,680 lekë, vlerë që përkon me 50% të vlerës totale të preventivit.

Lidhur me preventivin, rezulton se çmimet e vendosura për zërat e punimeve nuk përkojnë me manualin teknik të çmimeve miratuar me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", ku nga verifikimi i tyre rezulton se çmimet janë më të ulta se sa ato të manualit. Është paraqitur një shkresë e Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Bashkive të Qarkut Elbasan dhe për dijeni Prefektit të këtij Qarku, ku janë bashkëlidhur çmimet mesatarë të zërave të punimeve nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave. Sipas kësaj shkrese përcaktohen çmimet e zërave të punës për periudhën 2016 për Qytetin Elbasan.

Sa më sipër, evidentohet se shkresa është e pa plotë dhe nuk përcakton në mënyrë shteruese çmimet e punimeve të ndërtimit, pasi ato të paraqitura në shkresën e mësipërme citohet se janë për Qytetin Elbasan për vitin 2016, ndërkohë gjendemi në vitin 2023 dhe nuk rezulton të kemi përditësim të këtyre çmimeve ose shkresa ku të përcaktohen çmimet për vitin konkret.

Sa më sipër, Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, personat e ngarkuar për verifikimin e ligjshmërisë së aktit, duhet të evidentonin përputhshmërinë e vendimit me kriteret në fuqi që rregullojnë fushën e ndërtimit, për të përcaktuar një preventiv real, si në rastin e punimeve ndërtimore ashtu edhe ato që lidhen me orenditë shtëpiake, detyrë e cila nuk është kryer siç duhet. Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e punonjësve z. A. B. me detyrë specialist i emergjencave civile dhe krizave, z. E. G. me detyrë përgjegjës sektori i emergjencave civile dhe krizave, znj. A. G. me detyrë specialiste pranë sektorit juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua shkresa e Prefektit me nr. 556/1 prot., datë 18.05.2023 mbi ligjshmërinë e Vendimit të KB Gramsh me nr. 31, datë 10.05.2023 "Për Anulim të vendimit nr. 18, datë 28.02.2023 "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi kullosor publik për ndërtimit dhe operimin të HEC-eve "KUKUR 3" dhe "KUKUR 4" nga Shoqëria "K." shpk.

Rezulton se KB Gramsh, ka vendosur anulimin e vendimit nr. 18, datë 28.02.2023, kjo bazuar në propozimin e disa banorëve të fshatrave Gribë, Kalaj, me objekt tërheqjen e dakordësisë së KB me qëllim mos vijimin e procedurave të ndërtimit të 2 HEC-eve të mësipërm. Rezulton se pretendimi i banorëve konsiston në vendimmarrjen e këtij vendimi në kundërshtim me Kodin Zgjedhor 91 dhe 92, si dhe Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, i cili përcakton veprimtarinë dhe vendimmarrjet e ndaluara nga institucionet publike e shtetërore për një periudhë 4 mujore para datës së zgjedhjeve. Sipas ankuesve, procesi i vendimmarrjes së KB për dhënie dakordësie të fondit pyjor kullosor, përcaktohet se veprimtari e ndaluar, pasi kemi të bëjmë me dakordësi për dhënie pasurie brenda periudhës 4 mujore zgjedhore.

Gjithashtu, propozuesit e anulimit të vendimit, sqarojnë se vendimi për dhënie dakordësie është marrë me kuorumin prej 11 votash për ta futur në rendin e ditës dhe votuar si të tillë në mbledhjen përkatëse të KB Gramsh, vendim i cili bie ndesh me dispozitat e ligjit për vetëqeverisjen vendore, dhe germën (ii) të pikës (a) të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative. Nga ana

procedurale, sqarohet se vendimi i KB është marrë në kundërshtim me procedurat e mbledhjeve të KB, sepse kjo pikë e rendit të ditës sipas një pjese të mirë të Këshilltarëve është përfshirë pa lajmërimin më parë dhe pa u hedhur zyrtarisht në këshill, siç ndodh me çështjet jashtë rendit të ditës, për të cilat do duhej një votim specifik me $\frac{3}{4}$ e votave, ndërkohë rezulton se propozimi ka marrë 11 vota, nga 15 të kërkuara për raste të tilla.

-Lidhur me pretendimet e mësipërme, Prefekti i Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 556/1 prot., datë 18.05.2023 me lëndë *Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj*, ka kërkuar nga KB Gramsh që ti vihet në dispozicion se cilat kanë qenë shkaqet ligjore që ka marrë në konsideratë KB për të vendosur anulimin e vendimin të mëparshëm, dhe kërkon një informacion të hollësishëm se cilat janë pasojat që ka sjellë vendimi i datës 28.02.2023.

Lidhur me këtë qëndrim të Institucionit të Prefektit, audituesit e gjejnë të papërshtatshëm dhe jo të pabazuar në ligj, pasi në shkresën e kthyer nuk i është dhënë përgjigje vendimit të KB dhe argumenteve të ngritura. I kërkohet vënia në dijeni e shkaqeve ligjore, ndërkohë që shkaqet janë të paraqitura në vendimin për anulimin të marrë nga KB, ku janë cituar problematikat e vendimmarrjes që lidhen me Kodin Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9 të Komisioni Rregullator të KQZ-së, si dhe mangësitë me plotësimin e kuorumit për vendimmarrje të tilla. Sa më sipër, Institucioni i Prefektit në kthimin e Aktit nuk e ka argumentuar ligjërisht duke mos dhënë arsye dhe argumente ligjore.

Lidhur me mangësitë e mësipërme për kthimin e aktit pa argument ligjor përkatës, ngarkohen me përgjegjësi z. A. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, z. A. G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 1004/1 prot., datë 14.09.2023 i vendimit të KB Gramsh me nr. 63, datë 31.08.2023 “Për miratimin e ndryshimit të planit të buxhetit të Bashkisë Gramsh për vitin 2023”. Ky vendim i KB është në përgjigje të kërkesës së firmës sipërmarrëse “K.” shpk e cila kërkon kompensimin e pagës minimale sipas VKM-së nr. 113, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, dhe kontratës nr. 3946 prot., datë 15.10.2023 “Për shërbimin me sipërmarrje të pastrimit dhe transportit të mbeturinave, të gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekorit i qytetit Gramsh”.

Lidhur me afatin e konfirmimit të aktit, është bërë brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga neni 16, pika 2 germa (b) të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Nga shqyrtimi i vlefshmërisë së këtij vendimi, rezulton se personat e ngarkuar për vlefshmërinë e aktit, nuk kanë paraqitur asnjë relacion shpjegues për konfirmimin në parim të tij. Dosja nuk disponon analizën e shpenzimeve shtesë që rrjedh nga ndryshimi i pagës minimale, detyrim i cili duhet të ishte bërë nga personat e ngarkuar në Bashkinë Gramsh. Institucioni i Prefektit Elbasan, dhe personat e ngarkuar për shqyrtimin e këtij vendimi, nuk kanë administruar elementët e nevojshëm të kontratës ose të dhënat e kësaj përlllogaritjeje për të përcaktuar vlerën e saktë të shpenzimit shtesë. Konstatohet se është bërë një përlllogaritje ku përcaktohet vlera shtesë e kontratës për periudhën Prill – Dhjetor 2023 (1,552,876 lekë pa TVSH), për vitin 2024 (2,066,301 lekë pa TVSH) dhe për vitin 2025 (1,638,447 lekë pa TVSH).

Sipas sqarimeve të dhëna në relacionin e Drejtorisë Ekonomike të Bashkisë Gramsh, përcaktohet se kontrata fillestare është në vlerën 98,899,370 lekë pa TVSH. Kjo kontratë është ndryshuar, pa specifikuar arsyet e ndryshimit dhe vlera e saj shkon në vlerën 112,626,011 lekë pa TVSH. Në total, nga ndryshimi i pagës minimale për të cilën kërkohen ndryshimet e kontratës, vlera e saj shkon në 117,883,636 lekë, e cila sipas përlllogaritjeve të Drejtorisë Ekonomike të Bashkisë Gramsh është sa 18% e vlerës fillestare të kontratës prej 98,899,370 lekë pa TVSH. Përlllogaritjet e bëra rezultojnë të gabuara, pasi referuar masës së shtesës prej 18% të kontratës, rezulton se vlera e saj duhet të jetë 116,701,257 lekë, ose 1,182,379 lekë më pak. Sa më sipër, konstatohet se krahas gabimeve të kryera nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Gramsh, personat e ngarkuar për

vlefshmërinë e aktit nga Prefektura Elbasan e kanë kaluar për konfirmim pranë Prefektit pa bërë këto përlllogaritje, duke konfirmuar shtesën prej 1,182,379 lekë. Lidhur me këto mangësi për kalimin e konfirmimit të aktit pa analizën përkatëse të shtesës, si dhe për gabimet materiale në vlerën e saj prej 1,182,379 lekë, mban përgjegjësi znj. S. S. me detyrë Specialiste Finance, znj. A. Z. me detyrë Përgjegjëse se Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, dhe Prefekti i Qarkut Elbasan zj. M. P..

2. Bashkia Elbasan

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, në Prefekturën e Qarkut Elbasan janë administruar 110 vendime për konfirmim akti.

Lidhur me administrimin dhe trajtimin e vendimeve të administruara pranë Prefekturës, në të gjitha rastet nga pikëpamja formale është bërë hyrja në protokollin e institucionit, duke u sigluar data e hyrjes. Është bërë kalimi i shkresës më shënimin përkatës për sektorin i cili do bëjë trajtimin e saj sipas specifikës së vendimit. Shqyrtimi i aktit dhe konfirmimi, refuzimi apo kthimi i tij me shënimet përkatëse, është bërë në të gjitha rastet brenda afatit 10 ditë nga data e regjistrimit, në përputhje me nenin 16, pika 1 germa (b) “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” të ligjit me nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”. Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, janë administruar 110 akte të ardhura, nga të cilat janë konfirmuar 102 akte dhe 8 akte janë kthyer. Nuk ka asnjë akt të dërguar në gjykatë.

-Në aktin e konfirmimit, konstatohet se në thuajse të gjitha rastet mungon një relacion nga punonjësit e ngarkuar për shqyrtimin e aktit.

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 1116/3 prot., datë 19.10.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 87, datë 05.10.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së z. A. S. K., banor në lagjen “Emin Matraxhiu”, nr. 1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”*.

Lidhur me preventivin e paraqitur për punimet ndërtimore dhe preventivin e paraqitur për orenditë shtëpiake, rezulton se në të dyja rastet ka mos përputhje të çmimeve të preventivit. Konkretisht, preventivi për punimet ndërtimore, sipas hartuesve të tij bazohet në çmimet e miratuara në nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave, ndërkohë rezulton se çmimet janë më të ulta se sa ato të miratuara sipas manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, miratuar me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Sa më sipër, rezulton se komisioni nuk e ka mbështetur në dokumente preventivin e punimeve, dhe si e tille, Institucioni i Prefektit duhej të kërkonte shpjegime. Gjithashtu, preventivi për orenditë i përcaktuar në vlerën 162,000 lekë, rezulton se është përlllogaritur sipas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. 1806/1 prot., datë 29.02.2016. Lidhur me këtë preventiv, ai nuk paraqet në mënyrë reale vlerën mesatare të orendive, pasi kemi të bëjmë me çmime të një periudhe më shumë se 7 vjeçare, dhe duke pasur parasysh lëvizjen e madhe të çmimeve, kemi të bëjmë me një preventiv që nuk i përgjigjet situatës. Sa më sipër, Institucioni i Prefektit, duhej të kërkonte informacion për përditësimin e këtyre çmimeve, kjo për të mundësuar një vlerësim real të dëmeve të shkaktuara, sipas përcaktimit të pikës 2 germa (e) të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e punonjësve z. A. B. me detyrë specialist i emergjencave civile dhe krizave, z. E. G. me detyrë përgjegjës sektori i emergjencave civile dhe krizave, znj. A. G. me detyrë specialiste pranë sektorit juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 1117/3 prot., datë 19.10.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 88, datë 05.10.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së zj. Fatime Guri Selimi, banor në lagjen “Emin Matraxhiu”, nr. 1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”*.

Praktika e ndjekur për vlerësimin e vlerës së dëmeve të cilat janë në vlerën 95,901 lekë për punimet ndërtimore dhe 120,000 lekë për orenditë, është e njëjtë me praktikën e ndjekur në rastin e mësipërm, ku evidentohet se çmimet e përcaktuara në preventiv nuk janë të mbështetura, duke sjell si pasojë përcaktimin e preventivave jo real për dëmet e shkaktuara dhe mbështetjen financiare. Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e punonjësve z. A. B. me detyrë specialist i emergjencave civile dhe krizave, z. E. G. me detyrë përgjegjës sektori i emergjencave civile dhe krizave, znj. A. G. me detyrë specialiste pranë sektorit juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 1185/1 prot., datë 08.11.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 99, datë 31.10.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së z. Q. G., banor në lagjen “Dyli Haxhire”, nr. 3 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”*.

Praktika e ndjekur për vlerësimin e vlerës së dëmeve të cilat janë në vlerën 61,396 lekë për punimet ndërtimore dhe 99,000 lekë për orenditë, është e njëjtë me praktikën e ndjekur në rastin e mësipërm, ku evidentohet se çmimet e përcaktuara në preventiv nuk janë të mbështetura, duke sjell si pasojë përcaktimin e preventivave jo real për dëmet e shkaktuara dhe mbështetjen financiare.

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 1118/3 prot., datë 19.10.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 89, datë 05.10.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga rrëshqitja e banesës së z. P. R. Ç., banor në fshatin Griqan i Sipërm, Njësia Administrative Labinot Fushë dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”*.

Sipas relacionit shpjegues, si pasojë e rrëshqitjeve të ndodhura në Tetor 2020 (verifikuar nga Raporti Gjeologjik i muajit Tetor 2020), vlera e dëmeve të banesës së këtij shtetasi banues në fshatin Griqan i Sipërm është në shumën 2,712,670 lekë. Në relacion sqarohet se është riverifikuar situata me datë 10.03.2022 për dëmet që kishte pësuar banesa duke u mbajtur procesverbali përkatës. Në praktikën bashkëlidhur, gjendet një procesverbal konstatimi, i numerizuar në kokë me numër (6), i cili nuk ka të përcaktuar datën e mbajtjes.

Preventivi i hartuar, rezulton me mangësi si në rastet e mësipërme, pasi rezulton se çmimet e vendosura janë më të ulta se ato të përcaktuara në manualin teknik të çmimeve, miratuar me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”*.

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 1186/1 prot., datë 08.11.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 100, datë 31.10.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së z. A. N. M., banor në lagjen “28 Nëntori”, nr. 3 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”*.

Praktika e ndjekur për vlerësimin e vlerës së dëmeve të cilat janë në vlerën 88,450 lekë për punimet ndërtimore dhe 199,500 lekë për orenditë, është e njëjtë me praktikën e ndjekur në rastin e mësipërm, ku evidentohet se çmimet e përcaktuara në preventiv nuk janë të mbështetura, duke sjell si pasojë përcaktimin e preventivave jo real për dëmet e shkaktuara dhe mbështetjen financiare. Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e punonjësve z. A. B. me detyrë specialist i emergjencave civile dhe krizave, z. E. G. me detyrë përgjegjës sektori i emergjencave civile dhe krizave, znj. A. G. me detyrë specialiste pranë sektorit juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 1283/1 prot., datë 13.12.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 111, datë 30.11.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar*

nga djegia e banesës së zj. L. N. J., banore në lagjen “Emin Matraxhiu”, nr. 1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”.

Praktika e ndjekur për vlerësimin e vlerës së dëmeve të cilat janë në vlerën 202,650 lekë për punimet ndërtimore dhe 192,500 lekë për orenditë, është e njëjtë me praktikën e ndjekur në rastin e mësipërm, ku evidentohet se çmimet e përcaktuara në preventiv nuk janë të mbështetura, duke sjell si pasojë përcaktimin e preventivave jo real për dëmet e shkaktuara dhe mbështetjen financiare.

Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e punonjësve z. A. B. me detyrë specialist i emergjencave civile dhe krizave, z. E. G. me detyrë përgjegjës sektori i emergjencave civile dhe krizave, znj. A. G. me detyrë specialiste pranë sektorit juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 587/3 prot., datë 22.06.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 56, datë 26.05.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së zj. N. H. R. dhe 3 trashëgimtarëve të tjerë, banues në fshatin Mjekës të Njesisë Administrative Shirgjan dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”*.

Praktika e ndjekur për vlerësimin e vlerës së dëmeve të cilat janë në vlerën 307,531 lekë për punimet ndërtimore dhe 360,000 lekë për orenditë, është e njëjtë me praktikën e ndjekur në rastin e mësipërm, ku evidentohet se çmimet e përcaktuara në preventiv nuk janë të mbështetura, duke sjell si pasojë përcaktimin e preventivave jo real për dëmet e shkaktuara dhe mbështetjen financiare.

Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e punonjësve z. A. B. me detyrë specialist i emergjencave civile dhe krizave, z. E. G. me detyrë përgjegjës sektori i emergjencave civile dhe krizave, znj. A. G. me detyrë specialiste pranë sektorit juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 386/3 prot., datë 07.09.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 30, datë 28.03.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së z. A. X. A., banor në fshatin Lleshan Njësia Administrative Gjinat dhe dhënien e shpërblimit financiar”*.

Praktika e ndjekur për vlerësimin e vlerës së dëmeve të cilat janë në vlerën 1,307,496 lekë për punimet ndërtimore, është e njëjtë me praktikën e ndjekur në rastin e mësipërm, ku evidentohet se çmimet e përcaktuara në preventiv nuk janë të mbështetura, duke sjell si pasojë përcaktimin e preventivave jo real për dëmet e shkaktuara dhe mbështetjen financiare.

Mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi e punonjësve z. A. B. me detyrë specialist i emergjencave civile dhe krizave, z. E. G. me detyrë përgjegjës sektori i emergjencave civile dhe krizave, znj. A. G. me detyrë specialiste pranë sektorit juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikuar Konfirmimi i Aktit me nr. 1184/1 prot., datë 03.11.2023, i vendimit me nr. 98, datë 31.10.2023 me objekt *“Marrje me qira ambient/sallë (rinovim kontrate) për të zhvilluar mbledhje të Administratës së Bashkisë”*.

Konfirmimi i aktit është bërë brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 16, pika 1 germa (b) “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” të ligjit me nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Sipas këtij vendimi, është miratuar marrja me qira Salla e Konferencave të Hotel Turizmi “Skampa” në pronësi të Shoqërisë “R.” Sh.A. Qëllimi i kontratës është marrja me qira për zhvillimin e mbledhjeve të Administratës së Bashkisë për një periudhë 1 (një) vjeçare, me vlerë qiramarrje prej 17,000 lekë me TVSH për çdo mbledhje të zhvilluar të Administratës së Bashkisë. Në vendimin me nr. 98, datë 31.10.2023 të KB Elbasan, si dhe në relacionin bashkëlidhur këtij vendimi, citohet se është bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, dhe ligjin me nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Së pari, konstatohet se vendimi i KB dhe relacioni bashkëlidhur, nuk përcaktojnë të plotë bazën ligjore ku mbështetet ky vendim, dhe konfirmimi i aktit nga Prefekti i

Qarkut Elbasan është i pa plotë dhe i pambështetur, pasi nuk argumenton se ku mbështetet vendimi i KB Elbasan.

Së dyti, në vendimin e mësipërm dhe relacionin bashkëlidhur, është përcaktuar vlera 17,000 lekë për mbledhje për një periudhë 1 (një) vjeçare, ndërkohë nuk përcaktohet se sa është vlera totale e parashikuar për kryerjen e këtij shpenzimi nga Bashkia Elbasan. Vendimi i KB dhe konfirmimi i aktit nga Prefekti është i pa plotë dhe jo argumentues, pasi nuk përcakton modalitetet e nevojshme të kësaj kontrate qiraje, tipologjinë e mbledhjeve të administratës së Bashkisë Elbasan, kapacitetin e kërkuar dhe faktin se pse Bashkia Elbasan, tashmë e rinovuar, nuk mund të ofrojë mundësinë e zhvillimit të këtyre mbledhjeve. Audituesit, sqarojnë se shpenzimi prej 17,000 lekë për mbledhje administrate duke marrë ambiente me qira, duke mos përcaktuar dhe argumentuar modalitetet e këtyre mbledhjeve, përbën shpenzim pa efektivitet, për të cilin Prefekti i Qarkut Elbasan, duhej të shprehej pasi të dispononte gjithë informacionin e nevojshëm, bazueshmërinë ligjore për konfirmimin e këtij Akti, për të cilin ngarkohen me përgjegjësi z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 487/1 prot., datë 27.04.2023, i vendimit të KB Elbasan me nr. 39, datë 20.04.2023 me objekt *Mbi marrjen me qira të një mjeti (rinovim kontrate), për plotësimin e nevojave të transportit të administratës së Bashkisë Elbasan*”.

Konfirmimi i aktit është bërë brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 16, pika 1 germa (b) “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” të ligjit me nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Sipas këtij vendimi, miratohet rinovimi i kontratës për marrjen e një mjeti me qira të tipit Land Rover Discovery për një afat 1 vjeçar me vlerë qiramarrje prej 75,000 lekë/muaj me TVSH për t’u përdorur për plotësimin e nevojave të Administratës së Bashkisë.

Së pari evidentohet se baza ligjore është e pa plotë, duke mos përcaktuar dispozitat ligjore mbi të cilat bazohet ky vendim. Referuar ligjit me nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civil” i ndryshuar, nuk përcaktohet marrja e mjeteve me qira për administratën e bashkisë, në asnjërin nga lidhjet e këtij ligji, dhe aq më pak të përcaktohet vlera prej 75,000 lekë në muaj. Prefekti i Qarkut Elbasan në konfirmimin e këtij akti, nuk e argumenton mbështetjen në ligj të tij, duke i mundësuar nëpërmjet konfirmimit, kryerjen e shpenzimeve Bashkisë Elbasan në vlerën 75,000 lekë/muaj x 12 muaj = 900,000 lekë në vit. Vlen të theksohet, se kjo vlerë e cila rezulton rinovim kontratë, pra kemi një kontratë e cila zbatohet prej kohësh, Bashkia Elbasan mund të blinte mjete dhe ta dispononte atë si aset të saj, kjo për të mundësuar efektivitetin e fondeve. Sa më sipër, konfirmimi i këtij akti, nuk është i mbështetur në ligj, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi A. G. – Specialiste pranë sektorit juridik, Prefekti i Qarkut z. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 503 prot., datë 05.05.2023 i Vendimit të KB me nr. 49, datë 25.04.2023 me objekt *“Për financimin e aktiviteteve të Federatës Shqiptare të Çiklizmit”*.

Sipas këtij vendimi, përcaktohet financimi në vlerën 1,500,000 lekë për Federatën Shqiptare të Çiklizmit për aktivitetin “80 Tour of Albania”. Në relacionin shpjegues, përcaktohet se federata ka kërkuar mbështetje financiare për një pjesë të shpenzimeve që do zhvillohet përgjatë vitit 2023, pjesë e të cilave është edhe Bashkia Elbasan.

Në dosjen e përcjellë për konfirmim pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, nuk disponohet kërkesa nga Federata Shqiptare e Çiklizmit, mungon preventivi për përlogaritjen e këtij financimi, nuk është përcaktuar klasifikimi sipas programit ekonomik nga Bashkia Elbasan, dhe kapitujt respektiv nga ku do bëhet miratimi i fondeve që do preken. Sa më sipër, ka mangësi në miratimin e këtij akti, e cila ngarkon me përgjegjësi B. G. – Specialist, E. A., A. Z., dhe Prefekti i Qarkut Elbasan, z. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 345/1 prot., datë 16.03.2023 i vendimit të KB Elbasan me nr. 19, datë 09.03.2023 me objekt *“Për një shtesë në VKB nr. 189, datë 27.12.2022 “Për miratim dhënie burse për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional për vitin shkollor*

2022-2023”. Sipas këtij vendimi, miratohet një listë me 87 nxënës përfitues burse, të cilët sipas relacionit bashkëlidhur, rezultojnë kanë paraqitur me vonesë dokumentet përgjatë aplikimit në muajin Tetor – Nëntor 2022, mungesa e të cilave i ka skualifikuar. Lidhur me këtë vendim të KB Elbasan dhe të miratuar nga Prefekti, rezultojnë se vjen në kundërshtim me Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, entete shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Miratimi i këtij vendimi dhe konfirmimi i aktit nga Prefekti i Qarkut Elbasan, është në kundërshtim me nenin 3, pika 1.1 germa (b) të Vendimit Nr. 9 të cituar më sipër, i cili përcakton se *Veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:*

b) Mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik,....

Sa më sipër, lloji i veprimtarisë dhe vendimarrja e KB Elbasan, rezultojnë brenda afatit 4 (katër) mujor përpara datës së zgjedhjeve vendore të muajit Maj 2023, dhe si e tillë përfshihet në veprimtaritë e ndaluara. Për këto shkaqe prefekti nuk duhet të konfirmonte këtë. Lidhur me mangësitë e mësipërme, janë përgjegjësi znj. A. M. me detyrë Specialiste Turizmi dhe Funksionet e Deleguara, znj. E. A. me detyrë Përgjegjëse Sektori, Kompetencave Vendore, **Znj. L. B.**, me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme, z. A. G., me detyrë Përgjegjëse i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut Elbasan zj. M. P..

3. Bashkia Librazhd

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, në Prefekturën e Qarkut Elbasan janë administruar 104 vendime për konfirmim akti.

Lidhur me administrimin dhe trajtimin e vendimeve të administruara pranë Prefekturës, në të gjitha rastet nga pikëpamja formale është bërë hyrja në protokollin e institucionit, duke u sigluar data e hyrjes. Është bërë kalimi i shkresës më shënimin përkatës për sektorin i cili do bëjë trajtimin e saj sipas specifikës së vendimit. Shqyrtimi i aktit dhe konfirmimi, refuzimi apo kthimi i tij me shënimet përkatëse, është bërë në të gjitha rastet brenda afatit 10 ditë nga data e regjistrimit, në përputhje me nenin 16, pika 1 germa (b) “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” të ligjit me nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”. Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, janë administruar 104 akte të ardhura, nga të cilat janë konfirmuar 94 akte dhe 10 akte janë kthyer. Nuk ka asnjë akt të dërguar në gjykatë.

-Në aktin e konfirmimit, konstatohet se në thuajse të gjitha rastet mungon një relacion nga punonjësit e ngarkuar për shqyrtimin e aktit.

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 108/1 prot., datë 27.01.2023 i Prefektit të Qarkut Elbasani për vendimin e KB Librazhd me nr. 6 prot., datë 24.01.2023 “Për miratimin e bashkëfinancimit deri në masën 20% të projektit social “Për përmirësimin e kushteteve të banesave për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”. Sipas këtij vendimi, miratohet në parim bashkëfinancimi deri në masën 20% të projektit sipas objektit të mësipërm, efektet e të cilit sipas pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë. Miratimin në parim për angazhimin 20% të fondeve të buxhetit të bashkisë sipas objektit të vendimit, konsiderohet veprimtari e ndaluar sipas nenit 3 pika 1.1 germa (b) të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi është miratuar në parim mbështetja dhe promovimi i projekteve në investime me karakter social dhe ekonomik brenda periudhës 4 (katër) mujore, përpara zgjedhjeve

vendore të cilat janë mbajtur me datë 14 Maj 2023. Prefekti i Qarkut Elbasan nuk duhej të konfirmonte aktin e cili angazhon fonde në masën 20%. Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. A. G. me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik, znj. L. B., me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme, z. A. G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, dhe Prefekti i Qarkut Elbasan zj. M. P..

-Në vijim të Konfirmimit të Aktit të mësipërm, u verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 260/1 prot., datë 23.02.2023 i Prefektit, që lidhet me vendimin e KB Librazhd me nr. 14, datë 20.02.2023 me objekt *“Mbi miratimin në parim të listës emërore të familjeve që përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese”*. Sipas këtij vendimi, është përpiluar një listë me 49 emra të cilat përfitojnë nga programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese. Ky vendim, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut, rezulton në kundërshtim me nenin 3 pika 1.1 germa (b) të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi konsiderohet veprimtari e ndaluar.

-U verifikuar Konfirmimi i Aktit me nr. 445/1 prot., 19.04.2023 i vendimit të KB Librazhd me nr. 26, datë 31.03.2023 *“Për miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga fatkeqësi natyrore”*. Sipas këtij vendimi, përcaktohet mbështetja financiare për shtetasin S. L. për shkak se banesa është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore (lëkundje sizmike, cedime). Miratohet vlera e ndihmës emergjente prej 325,809 lekë, që përbën 50% të vlerës së dëmeve. Sipas praktikës bashkëlidhur këtij vendimi, është paraqitur një urdhër me nr. 540/4 prot., datë 23.09.2019 për ngritje komisioni për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (rënie tërmeti). Disponohet një procesverbal konstatimi nga sektori i emergjencave civile Bashkia Librazhd për konstatimin e dëmeve si dhe kërkesa e të dëmtuara S. L. që mban datën 24.09.2019.

Në vijim, është ngritur një urdhër tjetër me nr. 280, datë 15.03.2023, sipas të cilit urdhërohet të ngrihet komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore në shtëpi banimi në fshatin Funares, NjA Orenjë. Sipas këtij urdhri, komisioni do vlerësojë dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (rrëshqitje toke) në banesën e shtetasit S. L.. Është paraqitur preventivi, planimetria e objektit, certifikata familjare dhe certifikata e pronësisë. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur, së pari nuk argumentohet se para cilës emergjencë ndodhemi, asaj të tërmetit të datës 21.09.2019 apo rrëshqitjes së tokës sipas urdhrit nr. 280, datë 15.03.2023. Në zbatim të këtij urdhri, mungon procesverbali i konstatimit të rrëshqitjes edhe studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licencuara nëse është rrëshqitje toke, në kundërshtim me pikën 2, germa (a, e), të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*. Sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit justifikues për konfirmimin e këtij akti, ngarkohen me përgjegjësi Znj. M. Q. me detyrë Ish/ Specialiste pran Sektorit të Finance, Z. E. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Krizave, Znj. A. G., me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik dhe Prefekti Qarkut Elbasan, znj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 443/1 prot., datë 19.04.2023 i vendimit të KB Librazhd me nr. 24, datë 31.03.2023 me objekt *“Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi i subvencionimit të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti”*.

Sipas këtij vendimi miratohet lista me 4 familje që përfitojnë nga programi i subvencionimit, ku sipas tabelës nr. 2 jepet edhe vlera e kufirit maksimal të kredisë përfituese. Lidhur me këtë vendim të KB, rezulton i marrë në kundërshtim me Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, neni 3, pika 1.3, germa (c), e cila përcakton se Veprimtari të ndaluara, janë edhe ato që veprimtari që përfshijnë: *Vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142 të ligjit nr. 7850, datë*

29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrimin e organeve apo enteve publike në nivel qendror ose njësisive të vetëqeverisjes vendore.... Gjithashtu, pika 1.1, germa (b) e këtij vendimi, konsideron veprimtari të ndaluar, mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose investimeve, kombëtare ose **vendore, me karakter social dhe ekonomik**. Sa më sipër, natyra e këtyre vendimeve vjen në kundërshtim me Vendimin nr. 9 të cituar më sipër, dhe nenet 91 dhe 92 të ligjit me nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi znj. A. G., me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik dhe Prefekti i Qarkut Elbasan zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 440/1 prot., datë 19.04.2023 i Vendimit të KB Librazhd me nr. 21, datë 31.03.2023 “Mbi përdorimin e fondit të Emergjencave Civile”. Sipas këtij vendimi, miratohet përdorimi i fondit në vlerën 120,000 lekë për hartim projekti për objektin banesë individuale 1k+çati e thjeshtë (modul për përdorim në programin e emergjencave civile). Lidhur me përdorimin e këtij fondi, jemi sërish në kushtet e angazhimit të fondeve të emergjencës në periudhë zgjedhore, në kundërshtim me Vendimin nr. 9 të cituar edhe më sipër, i cili përcakton qartë në nenin 3 pika 1.2 ku shprehet se *Përrjashtimisht, në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo epidemisë/pandemisë, nuk zbatohen përcaktimet e pikës 1.1 të këtij neni...* Konfirmimi i aktit vjen në kundërshtim me Vendimin nr. 9 të cituar edhe më lart, për të cilin ngarkohet me përgjegjësi znj. M. Q. me detyrë ish/Specialiste Finance, znj. S. S. me detyrë Specialiste Finance, z. E. G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Krizave, z. A. G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti i Qarkut z. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 264/1 prot., datë 23.02.2023 i vendimit me nr. 18, datë 17.02..2023 të KB Librazhd me objekt “Për miratimin e ndërtimit të varrezave të reja në lagjen qendër, fshati Xhyrë, NjA Hotolisht”. Bashkëlidhur këtij vendimi është paraqitur një hartë me të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga geoportal.asig.gov.al, ndërkohë nuk paraqitet asnjë dokumentacion pronësor mbi këtë pronë, plan rilevimi topografik etj. Në mungesë të dokumentacionit justifikues, Prefekti i Qarkut duhej të kthente për plotësim dokumentacioni aktin. Sa më sipër, mban përgjegjësi z. A. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, znj.L. B., me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme, znj. A. G. me detyrë me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 263/1 prot., datë 24.02.2023 i KB Librazhd për vendimin me nr. 17, datë 17.02.2023 “Për miratimin e projektit “Ndërtim Miniparku në hyrjen e gjimnazit Ibrahim Muça, Bashkia Librazhd”. Sipas këtij vendimi, miratohet projekti i ndërtimit të parkut, vlera e projektit të të cilit është 3,230,503 lekë. Sipas këtij vendimi nuk përcaktohet burimi i financimit dhe llogaritë ekonomike që do preken, ndërkohë që projekti është miratuar në kundërshtim me vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së i cituar edhe më sipër, i cili përfshin projektin në veprimtaritë e ndaluarat përgjatë periudhës zgjedhore 4 muaj para datës së zgjedhjeve. Prefekti i Qarkut Elbasan nuk duhej të konfirmonte aktin e mësipërm. Për këto mangësi ngarkohet me përgjegjësi z. A. K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, Znj.L. B., me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme, Znj. A. G., me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik dhe Prefekti i Qarkut zj. M. P..

-Në vijim, konstatohet se Konfirmimi i Aktit me nr. 572/1 prot., datë 22.05.2023 i Vendimit të KB Librazhd me nr. 52, datë 12.05.2023 me objekt “Ndihmë financiare”, sipas të cilit i jepet ndihmë për vështirësi familjare në vlerën 100,000 lekë shtetasit Fredi Mevlut Kiptiu, është dhënë në kundërshtim me vendimin nr. 9 të cituar edhe më sipër, pasi angazhimi i fondeve 2 ditë para zgjedhjeve konsiderohet veprimtari e ndaluar, dhe si e tillë nuk duhej konfirmuar nga Prefekti.

Veprimet janë përgjegjësi e Z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

Situatë e ngjashme është edhe vendimi i KB me nr. 47, datë 12.05.2023 për dhënie ndihme financiare për shtetasin N. M., i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 567/1 prot., datë 22.05.2023

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 542/3 prot., datë 17.10.2023 i vendimit të KB Librazhd me nr. 42, datë 28.04.2023 *“Për dhurimin e pasurisë nr. 7/143-A me sipërfaqe 217 m² në favor të Komunitetit Mysliman Shqiptar (Bashkia Librazhd).*

Referuar këtij vendimi, pasuria e mësipërme kalon në pronësi të Komunitetit Mysliman Shqiptar, për ndërtimin e një xhamie të re. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se Bashkia Librazhd nuk ka paraqitur asnjë dokument pronësor për të vërtetuar statusin juridik të pronës, e cila do i dhurohet Komunitetit Mysliman. Gjithashtu, ky vendim i KB vijon të vijë në kundërshtim me Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, neni 3, pika 1.3 germa (c), e cila konsideron veprimtari të ndaluar vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme....*Lidhur me këto mangësi, janë përgjegjësi e znj. A. G., me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik, z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..*

4.Bashkia Përrenjas

-U verifikua kthimi i aktit me nr. 1308/1 prot., datë 15.2.2023 i vendimit të KB Përrenjas me nr. 110, datë 06.12.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në objektin e banimit të z. S. M., banor në fshatin Qukës, Nj.A Qukës dhe shpërblimin e plotë nga ana e Bashkisë Përrenjas”.*

Sipas këtij vendimi, i miratohet vlera financiare për dëmet e shkaktuara në shumën 604,264 lekë, nga të cilat 428,744 lekë nga fondi i kushtëzuar dhe 175,520 lekë nga fondi i emergjencave të Bashkisë Përrenjas. Sipas relacionit bashkëlidhur, kemi të bëjmë me një ndërtesë të ndërtuar para viteve 1990, e cila ka pësuar dëmtime të mëdha për shkaqe të ndryshme natyrore, sidomos tërmete me magnitudë të vogël, reshjet e borës, të shiut etj. Mbi bazën e kërkesës së këtij shtetasi, është ngritur grupi i punës nga për verifikimin e dëmeve me nr. 498, datë 16.11.2023, i cili ka hartuar aktin e konstatimit që mban datën 17.11.2023, i cili ka pasqyruar situatën e objektit dhe ndërhyrjen e nevojshme bashkëlidhur edhe preventivin. Lidhur me këtë vendim, rezulton se Prefekti i Qarkut Elbasan i ka kthyer si të pabazuar në ligj, me argumentin se janë tejkaluar afatet ligjore të parashikuara në VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”,* Kap. III, pika 1. Lidhur me këtë kthim akti, rezulton se baza ligjore e cituar nuk përputhet, pasi VKM e mësipërme përcakton afate që lidhen me ngritjen e komisionit deri në përfundimin e hartimit të procesverbalit (5 ditë), dhe në asnjë pjesë nuk përcaktohen afate që lidhen me kohën e ngjarjes për të cilën fillojnë procedurat e vlerësimit të dëmeve. Sa më sipër, për refuzimin e aktit duke mos argumentuar ligjërisht këtë refuzim, ngarkohen me përgjegjësi A. B., E.G., A.G. dhe Prefekti Qarkut zj. M. P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 515/1 prot., datë 04.05.2023 vendimit të KB Përrenjas me nr. 49, datë 26.04.2023 me objekt *“Për një shtesë në miratimin e listës së familjeve të cilat do të përfitojnë subvencion të qirasë në tregun e lirë me kërkesë për mbështetje nga buxheti i shtetit”.*

Sipas këtij vendimi miratohet lista me 15 familje që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë në tregun e lirë. Lidhur me këtë vendim të KB, rezulton i marrë në kundërshtim me Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, neni 3, pika 1.3, germa (c), e cila përcakton se Veprimtari të ndaluar, janë edhe ato që veprimtari që përfshijnë: *Vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142 të*

ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrimin e organeve apo enteve publike në nivel qendror ose njësive të vetëqeverisjes vendore.... Gjithashtu, pika 1.1, germa (b) e këtij vendimi, konsideron veprimtari të ndaluar, mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose investimeve, kombëtare ose **vendore, me karakter social dhe ekonomik**. Sa më sipër, natyra e këtyre vendimeve vjen në kundërshtim me Vendimin nr. 9 të cituar më sipër, dhe nenet 91 dhe 92 të ligjit me nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi Znj. A. G., me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik, z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti i Qarkut Elbasan znj. M. P..

-Në vijim është konfirmuar akti me nr. 516/1 prot., datë 04.05.2023 i vendimit të KB Përrenjas me nr. 50, datë 24.04.2023 me objekt *“Për propozimin për miratim të listës së familjeve që do të përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti nëpërmjet projektit të subvencionimit të interesave të kredisë”*. Sipas këtij vendimi miratohet lista me 1 (një) familje që do përfitojë nga programi i banesave me kosto të ulët nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë. Ky vendim dhe konfirmimi i tij vjen sërish në kundërshtim me Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së, pasi përfshihet në veprimtaritë e ndaluara përgjatë periudhës 4 muaj para zgjedhjeve.

-Gjithashtu, u verifikua konfirmimi i aktit me nr. 514/1 prot., datë 04.05.2023 i vendimit të KB Përrenjas me nr. 48, datë 24.04.2023 me objekt *Për miratimin e formalizimit të kontratës të z. H. B. P. në zbatim të VKM-së nr. 179, datë 26.02.2020*. Sipas këtij vendimi, formalizohet kontrata me z. H. B. P., për pajisjen me certifikatë pronësie të apartamentit të tij sipas dokumentacionit të depozituar në dosjen e privatizimit. Ky vendim rezulton gjithashtu në kundërshtim me vendimin nr. 9 të cituar më sipër, pika 1.3, germa (b).

-Nga verifikimi rezulton se edhe konfirmimi i aktit me nr. 400/1 prot., datë 04.04.2023 i vendimit të KB me nr. 43, datë 24.03.2023 me objekt *Për dhënien në përdorim të sipërfaqes së caktuar të fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të Bashkisë Përrenjas*, vijon të jetë në vazhdim të akteve që bien në kundërshtim me Vendimin nr. 9 të cituar më sipër, pasi të gjitha rastet konsiderohen veprimtari të ndaluara për shkak të periudhës 4 muaj përpara zgjedhjeve.

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 398/1 prot., datë 06.04.2023 i vendimit të KB Përrenjas me nr. 41, datë 24.03.2023 me objekt *“Për dhënien e autorizimit për nisjen e procedurave për dhënien me koncesion/partneritet publik privat “Për ndërtimin e tregut industrial dhe ushqimor të Bashkisë Përrenjas”*. Sipas këtij vendimi, autorizohet nisja e procedurave për dhënien me koncesion sipas objektit, për të cilën ngarkohen me detyrimin për zbatim Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Lidhur me këtë vendim, rezulton edhe ky në kundërshtim të hapur me Vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator të KQZ-së cituar më sipër, Kreu III, neni 3, pika 1.1, germa (a), e cila konsideron veprimtari të ndaluar për shkak të periudhës zgjedhore, mbështetjen dhe promovimin e projekteve/investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore. Sa më sipër, për konfirmimin e këtij akti, ngarkohen me përgjegjësi z. A. K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

-Në vijim të vendimeve në kundërshtim me vendimin nr. 9 cituar më sipër, është edhe konfirmimi i aktit me nr. 394/1 prot., datë 03.04.2023 i vendimit të KB Përrenjas me nr. 38, datë 24.0.2023 me objekt *“Për përdorim fondi social për familje në nevojë për vitin 2023”*. Sipas këtij vendimi, miratohet dhënia e ndihmës financiare për 3 familje në vlerën 1,066,000 lekë, e cila është në kundërshtim me germën Kreun III, neni 3, pika 1.1, germa (b), e cila konsideron veprimtari të ndaluar mbështetjen dhe promovimin e projekteve kombëtare ose **vendore me karakter social dhe ekonomik**. . Sa më sipër, për konfirmimin e këtij akti, ngarkohen me përgjegjësi z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

5.Bashkia Cërrik

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, në Prefekturën e Qarkut Elbasan janë administruar 80 vendime për konfirmim akti të dërguara nga Bashkia Cërrik.

Lidhur me administrimin dhe trajtimin e vendimeve të administruara pranë Prefekturës, në të gjitha rastet nga pikëpamja formale është bërë hyrja në protokollin e institucionit, duke u sigluar data e hyrjes. Është bërë kalimi i shkresës më shënimin përkatës për sektorin i cili do bëjë trajtimin e saj sipas specifikës së vendimit. Shqyrtimi i aktit dhe konfirmimi, refuzimi apo kthimi i tij me shënimet përkatëse, është bërë në të gjitha rastet brenda afatit 10 ditë nga data e regjistrimit, në përputhje me nenin 16, pika 1 germa (b) “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” të ligjit me nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”. Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, janë administruar 80 akte të ardhura, nga të cilat janë konfirmuar 78 akte dhe 2 akte janë kthyer. Nuk ka asnjë akt të dërguar në gjykatë.

-Në aktin e konfirmimit, konstatohet se në thuajse të gjitha rastet mungon një relacion nga punonjësit e ngarkuar për shqyrtimin e aktit.

-U verifikua konfirmimi i Aktit me nr. 313/1 prot., datë 15.03.2023 i vendimit të KB Cërrik me nr. 19, datë 27.02.2023 me objekt *“Për miratimin e vlerave maksimale të kredisë së lehtësuar nga shteti që përfitojnë familjet nga Programi i strehimit “Banesë me kosto të ulët (BKU)”*. Sipas këtij vendimi, miratohet vlera maksimale e kredisë së lehtësuar nga shteti ku sipas relacionit bashkëlidhur janë 3 familje. Ky vendim bazohet në shkresën nr. 18627 prot., datë 17.10.2019. Lidhur me periudhën e këtij vendimi, rezulton se është marrë në periudhën 4 muaj para zgjedhjeve, periudhë e cila përcakton kufizime të disa vendimmarrjeve, ku përfshihet edhe objekti i këtij vendimi, konkretisht Kreu II, neni 3, pika 1.1 germa (b) e vendimit nr. nr 9, datë 24.12.2020, cituar edhe në rastet tjera të mësipërme. Konfirmimi nga administrata e prefektit e kësaj kategori vendimesh, ngarkon me përgjegjësi znj.L. B., me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme, z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

-Në vijim të mangësisë së mësipërme, rezulton edhe Konfirmimi i Aktit me nr. 426/1 prot., datë 13.04.2023 i vendimit të KB Cërrik me nr. 25, datë 31.03.2023 me objekt *Për miratimin e dhënies me infiteozë të objektit me nr. pasurie 332 ZK 1389 me sipërfaqe 753 m²*. Ky vendim vjen në kundërshtim me vendimit të mësipërm pasi konsiderohet veprimtari e ndaluar për shkak të periudhës 4 mujore para zgjedhjeve, dhe konkretisht të Kreut II, neni 3, pika 1.3 germa (c), e cila konsideron veprimtari të ndaluar vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.... Sa më sipër, për konfirmimin e këtij akti, ngarkohen me përgjegjësi z. A. K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

-Gjithashtu, vendimi nr. 24 i KB Cërrik me objekt *“Për miratimin e transferimit të fondeve”*, i konfirmuar nga prefekti me shkresën nr. 425/1 prot., datë 14.04.2023, konsiderohet veprimtari e ndaluar sipas vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator pranë KQZ, neni 3, pika 1.1 e cila përcakton se *“Veprimtari të ndaluar për tu promovuar”*, janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo **janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.... Lidhur me kalimin e këtij vendimi, mban përgjegjësi z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

6.Bashkia Belsh.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, në Prefekturën e Qarkut Elbasan janë administruar 57 vendime për konfirmim akti.

Lidhur me administrimin dhe trajtimin e vendimeve të administruara pranë Prefekturës, në të gjitha rastet nga pikëpamja formale është bërë hyrja në protokollin e institucionit, duke u sigluar data e hyrjes. Është bërë kalimi i shkresës më shënimin përkatës për sektorin i cili do bëjë trajtimin e saj sipas specifikës së vendimit. Shqyrtimi i aktit dhe konfirmimi, refuzimi apo kthimi i tij me shënimet përkatëse, është bërë në të gjitha rastet brenda afatit 10 ditë nga data e regjistrimit, në përputhje me nenin 16, pika 1 germa (b) “Verifikimi i ligjshmërisë së akteve” të ligjit me nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

-Në aktin e konfirmimit, konstatohet se në thuajse të gjitha rastet mungon një relacion nga punonjësit e ngarkuar për shqyrtimin e aktit.

-U verifikuan 3 konfirmime për konfirmimi akti, konkretisht vendimet e KB Belsh me nr. 1, datë 24.01.2023 me objekt “Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2023”, me nr. 9, datë 10.02.2023 me objekt “Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2023”, dhe vendimi me nr. 14, datë 24.03.2023 me objekt *Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2023*. Ndryshimet në buxhet, për të cilat janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar në periudhën 4 (katër) mujore para datës që zgjedhjeve, është në kundërshtim me nenin 3 pika 1.1 të Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së. Sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi L.B., dhe Prefekti Qarkut zj. M.P..

-U verifikua Konfirmimi i Aktit me nr. 871/3 prot., datë 08.12.2023 i vendimit të KB Belsh me nr. 43 dhe 2026 prot., datë 31.07.2023. Objekti i këtij vendimi është “për miratimin e procedurës së vlerësimit për objektin (shtëpi banimi) të z. A. A. Q. të dëmtuar nga zjarri”. Sipas këtij vendimi, miratohet procedura e vlerësimit të dëmeve për objektin e këtij shtetasi me vlerë financiare 1,073,843 lekë për objektin dhe 498,000 lekë për orenditë. Në praktikën e administruar nuk disponohet kërkesa e palës së dëmtuar, si dhe urdhri për ngritjen e komisionit për kryerjen e vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të Kreut III, pika 1 të VKM-së nr. 629, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

-Bashkëlidhur praktikës është një preventiv për punime ndërtimi në vlerën 1,073,843 lekë, bazuar sipas çmimeve të manualit teknik sipas VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre”, si dhe një preventiv tjetër për vlerën e orendive prej 498,000 lekë për të cilin nuk përcaktohet mënyra e përlllogaritjes. Me shkresën nr. 871/1 prot., datë 08.08.2023 të Prefektit të Qarkut Elbasan, është kthyer përgjigje për mos konfirmimin e aktit, duke kërkuar të dhëna shtesë dhe duke përcaktuar se vendimi nr. 43, datë 31.07.2023 është i pa plotë si nga ana formale dhe nga përmbajtja, pasi miraton procedurën por nuk miraton vlera e dëmshpërblimit. Bashkia Belsh, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3308/1 prot., datë 31.11.2023 ku ka bashkëngjitur vendimin nr. 43, datë 28.07.2023 duke përcaktuar se është sipas formatit dhe kërkesave të cituara në shkresën e Prefektit për kthimin e aktit. Vihet re se Vendimi nr. 43, dhe nr. 2026 prot., datë 31.07.2023, i cili i është bashkëngjitur shkresës së mësipërme, ka përmbajtje tjetër në objektin e tij dhe konkretisht “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e z. A. A. Q., banor i fshatit Hardhi, Njësia Administrative Fjerzë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Belsh”. Sipas këtij vendimi, miratohet vlera financiare e dëmshpërblimit e cila është në vlerën **1,571,843 lekë / 50% = 785,921 lekë**. Fondet për këtë financim sipas vendimit kanë ardhur nga Ministria e Mbrojtjes nga fondi i kushtëzuar.

Nga verifikimi i praktikës së mësipërme, kemi mospërputhje në formë, përmbajtja dhe në vlerën e përcaktuar të dëmeve. Rezulton se janë paraqitur 2 vendime që mbajnë nr. 43, nr. 2026 prot., datë 31.07.2023, por në objekt janë të ndryshme si dhe në vlerën financiare janë sërish të ndryshme. Në vendimin e parë i cili është kthyer nga prefekti, kemi 1 preventiv punimesh dhe 1 për orenditë. Preventivi i punimeve është në vlerën **1,073,843 lekë** dhe sipas VKM-së nr. 329 cituar më sipër, përfitohet 50% e dëmeve ndërtimore që i bie të jetë vlera 536,921 lekë, si dhe preventivi për orenditë në vlerën **498,000 lekë**. Nga përlllogaritja e mësipërme, duhej që vendimi i bazuar mbi dokumentacionin e paraqitur, të përkojë me vlerën totale **1,034,921 lekë**. Rezulton se pas kthimit të aktit nga Prefekti, është paraqitur një vendim tjetër i KB Belsh, i cili mban të njëjtin numër vendimi, konkretisht 43, të njëjtin numër protokolli, konkretisht 2026 dhe të njëjtën datë 31.07.2023. Rezulton se vendimi i dytë ka ndryshuar objektin e tij siç është pasqyruar më sipër, si dhe ka ndryshuar vlerat e dëmit, duke përcaktuar vetëm dëmet ndërtimore në vlerën totale 785,921 lekë, vlerë e cila është më e ulët se sa vlera e vendimit të parë të administruar, si dhe nuk është përcaktuar asnjë vlerë për dëmin e orendive. Sa më sipër, konstatohet se KB Belsh, ka paraqitur 2 vendime të njëjta në numër dhe datë, por me përmbajtje të ndryshme dhe vlera të ndryshme që lidhen me dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në objektin e shtetasit A. A. Q., të cilat, pavarësisht mangësive në formë dhe përmbajtje, është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 871/3 prot., datë 08.12.2023, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi A.B., E.G., A.G. dhe Prefekti Qarkut zj. M. P..

-U verifikua konfirmimi i Aktit me nr. 218/3 prot., datë 13.02.2023 i KB Belsh me objekt *“Për miratimin e banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara në Bashkinë Belsh”*. Sipas këtij vendimi, miratohet përmirësimi i 43 banesave si dhe bashkëfinancimi i projektit total në vlerën 48,131,274 lekë, ku Bashkia Belsh mbulon 20% të projektit ose 8,021,879 lekë dhe Buxheti i Shtetit në vlerën 40,109,395 lekë. Në materialin bashkëlidhur, relacionin dhe pjesën mbështetëse të këtij vendimi, nuk është përcaktuar në asnjë moment se me çfarë shkrese të ministrisë së linjës është bërë financimi në masën 80%, mbi të cilën Bashkia Belsh do miratonte pjesën takuese prej 20%. Sa më sipër, vendimmarrje të tilla, për angazhim fondesh pa mbështetur në buxhete të miratuara apo në shkresa të përcjella nga bashkëfinancuesit, e cila realizohet njëkohësisht përgjatë periudhës 4 muaj para zgjedhjeve të muajit Maj 2023, është në kundërshtim me nenin Kreun II, nenin 3 pika 1.1 germa (b) të vendimit nr. 9, datë 10.02.2023 me objekt *“Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2023”*, dhe vendimi me nr. 14, datë 24.03.2023 me objekt *Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2023”*. Sa më sipër, për konfirmimin e këtij akti, ngarkohen me përgjegjësi z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prefekti Qarkut znj. M. P..

7. Bashkia Peqin viti 2023

1. Këshilli Bashkiak Peqin me Vendimin nr. 68 date 15.12.2023 ka miratuar nisjen e procedurës “Mbi shpronësimin e pasurive që preken për efekt të zgjerimit të sipërfaqeve së varrezave publike të qytetit të Peqinit”. Bashkëlidhur VKB nr. 68 date 15.12.2022 është përcjell:

- Planë Vendosja e tokës që shpronësohet për zgjerimin e varrezave të qytetit të Peqinit, Sipërfaqja 4000m², nr. Pasurie 232/7 z.k 3055 indeksi i hartës k-34-101-(217-c)-proger, miratuar nga kryetari i bashkisë z. B. M..

- Vkm nr 89 datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në republikën e Shqipërisë”

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 68 date 15.12.2023 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 68 prot., datë 15.12.2023 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Peqin është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

- Procesverbali i mbledhjes së këshillit;

- Projektvendim;

- Statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave), plan vendosjet e pasurive të cilat preken nga projekti i “zgjerimit të sipërfaqeve së varrezave publike të qytetit të Peqinit” zk. 3055;

- Certifikata e pronsisë e personave të cilët preken nga VKB nr. 68 date 15.12.2023, respektivisht; nr. Pasurie 232/7 lloji Are, Z.k. 3055 Fshati Pogër.
- Urdhrin për komisionin e posaçëm nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimit, për ndjekjen dhe realizimin e procedura të shpronësimit;
- Akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë Peqin
- Mungon përlllogaritja e shpronësimit për pasurin nr. 232/7 lloji Are, Z.k. 3055 Fshati Pogër në zbatim të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private në interes publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret e vlerësimit dhe përlllogaritjes të masës të shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtat e personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar me VKM nr. 395, datë 13.05.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASHSH”.

Megjithëse nga ana e Bashkisë Peqin nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën 1361/1 prot., datë 21.12.2023 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. A. K. me detyrë përgjegjës i sektorit të zhvillimit urban, z. A. G. me detyrë përgjegjës i sektorit juridik.

2. Këshilli Bashkiak Peqin me Vendimin nr. 32 date 21.06.2023 ka miratuar nisjen e procedurës “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit tip Benz Avangart”. Bashkëlidhur VKB nr. 32 date 21.06.2023 është përcjell:

- Procesverbal i datës 20.06.2023 “Mbi gjendjen teknike të automjetit tip Avangart me targa AA.....;

Nga auditimi konstatohet se:

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur VKB nr. 32 date 21.06.2023 dhe dokumentacionit bashkëlidhur vendimit përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan nga subjekti Bashkia Peqin është i pamjaftueshëm për tu shprehur “Në parim si të bazuar në ligj” pasi mungon dokumentacioni i nevojshëm konkretisht:

- Procesverbali i mbledhjes së këshillit;
- Projektvendim;
- Relacioni i KB

Gjithashtu mungojnë arsyet e nxjerrjes nga përdorimi, vlerësimet e ekspertit të fushës si dhe metoda që propozohet për daljen nga përdorimi referuar udhëzimit nr. 11 datë 06.05.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Megjithëse nga ana e Bashkisë Peqin nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën 32 prot., datë 03.7.2023 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., znj S. S.. me detyrë specialiste në e sektorin e financës, znj. A. Z. me detyrë përgjegjës e sektorit të financës, z. A. G. me detyrë përgjegjës i sektorit juridik.

3. Këshilli Bashkiak Peqin me Vendimin nr. 13 date 24.02.2023 ka miratuar nisjen e procedurës “Miratimin e Analizës së Kostos për shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane”. Bashkëlidhur VKB nr. 13 date 24.02.2023 nuk ka asnjë dokumentacion bashkëlidhur:

Nga auditimi konstatohet se:

Megjithëse nga ana e Bashkisë Peqin nuk është përcjell i gjithë dokumentacioni i detyrueshëm, Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën 348 prot., datë 17.03.2023 ka konfirmuar aktin “Në parim mbështetjen e tij në ligj” në kundërshtim ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 4 Aneksi 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut, ngarkohet

me përgjegjësi për periudhën objekt auditimi prefekti i qarkut Elbasan Znj. M. P., z. A. K. me detyrë përgjegjës i sektorit të zhvillimit urban, dhe z. A. G. me detyrë përgjegjës i sektorit juridik.

Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

Nga grupi i auditimit, u verifikua verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve, detyrim që rrjedh nga neni 17 i ligjit nr. 107/016 “Për Prefektin e Qarkut”. Për periudhën 01.0.2023 – 31.12.2023 situata rezulton si më poshtë:

-Në të gjitha Bashkitë e Qarkut Elbasan si dhe në Këshillin e Qarkut Elbasan, janë kryer verifikimet në vend të ligjshmërisë së akteve, të cilat janë pasqyruar me Programin përkatës të miratuar nga Titullari, Akt Verifikimi i mbajtur pranë njësive si dhe shkresa me konkluzionet përfundimtare dërguar njësisë ku është kryer verifikimi. Për periudhën objekt auditimi, rezulton se për 3 mujorin e parë dhe të dytë të vitit 2023, janë kryer verifikimet përkatëse në të gjitha njësitë, ndërkohë që rezulton se për 3 mujorin e tretë dhe të katërt të vitit është kryer vetëm një verifikim i cili ka për objekt 6 – mujore nga data 01.07.2023 – 31.12.2023. Kryerja e verifikimit për intervalin 6 mujor është në kundërshtim me pikën 1 të neni 17 të ligjit nr. 107/2016 “Prefekti e Qarkut”, i cili përcakton se:

<i>1. Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj.</i>
--

Sa më sipër, Prefekti i Qarkut Elbasan nuk ka respektuar detyrimin e përcaktuar në nenin e mësipërm, i cili përcakton se verifikimi kryhet jo më pak se një herë në 3 muaj.

-Gjithashtu, konstatohet nga verifikimi i Akt Verifikimeve të mbajtura pranë njësive për kontrollin e ligjshmërisë së akteve në vend, se në të gjitha rastet aktet janë të pa protokolluara, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

IV.GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ dhe sistematik në organin e njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2022, rezulton se:

Nga ana e sektorit juridik të institucionit të prefektit të Qarkut Elbasan, janë zhvilluar kontrole periodike në NJVQV të Qarkut Elbasan.

Në zbatim të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e Qarkut” neni 17 për vitin 2022 institucioni i prefektit të qarkut Elbasan, ka përcjell programet e verifikimit në terren mbi ligjshmërinë e akteve normative në Bashkinë Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Librazhd, Prenjas, Peqin dhe Këshillin e Qarkut Elbasan me objekt:

-Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të miratuara nga Këshilli Bashkiak/Qarku

-Respektimi i ligjit nr.107/2016 “ Për Prefektin e Qarkut”, neni 16.

-Respektimi i ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar

-Ligjshmërinë e akteve normative që nuk janë dërguar për shprehje ligjshmërie tek Prefekti.

-Verifikimin në vend i ligjshmërisë së akteve normative të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Për vitin 2022 Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, ka realizuar në total 24 verifikim në terren, dhe për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore janë realizuar 3 verifikime, pasi në 6 mujorin e dytë

të vitit 2022, verifikimi në terren është realizuar për periudhën 6 mujore dhe jo për çdo periudhë 3 mujore, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2016 “ Për prefektin e qarkut” neni 17.

-Rekomandimi i grupit të punës për verifikimin në Bashkinë Gramsh, nuk ka përputhje me konstatimin e grupit të verifikimit në lidhje me vendimin nr.50 datë 31.05.2022, ku para shprehjes mbi ligjshmërinë e aktit janë kërkuar të dhëna plotësuese të cilat nuk janë dërguar deri në datën e mbajtjes së akt verifikimit në Bashkinë Gramsh, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Elbasan në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin në terren të akteve të nxjerra nga Njësitë e Qeverisjes vendore të qarkut Elbasan dhe nëpërmjet strukturave përgjegjëse të bëjë monitorimin e raporteve të këtyre grupeve për çdo 3 mujor për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore.

1.2. Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të qarkut Elbasan, nëpërmjet akteve të brendshme administrative dhe brenda strukturës organizative, para shprehjes së konfirmimit të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore të ngrejë një strukturë për sigurimin e cilësisë së dokumentacionit shoqërues të akteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore të qarkut Elbasan

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi verifikimin në vend të zbatimit të ligjshmërisë, rezulton se grupet e punës gjatë verifikimit në terren të akteve normative të këshillave bashkiak dhe këshillit të qarkut Elbasan nuk kanë mbajtur Akt Konstatim sipas një formati të miratuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan në subjektet Bashkinë Belsh, Bashkia Cërrik, Këshillin e Qarkut Elbasan dhe Bashkinë Elbasan për periudhën janar mars, sipas përcaktimeve të nenin 5 germa “e” të Aneks I “ Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, ku parashikohet se:

Gjatë procesit të verifikimit në vend në institucionin e NJVV, grupi i punës mban një akt konstatimi, i cili nënshkruhet dhe nga përfaqësuesit e NJVV-së.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të qarkut Elbasan të miratojë një model tip me gjithë elementeve e nevojshëm formal të akt konstatimit që grupet e verifikimit duhet të mbajnë pranë njëjësive të vetëqeverisjes vendore, gjatë verifikimit në terren.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i VKB nr. 7 date 07.03.2022 i protokolluar më datë 10.03.2022 rezulton se:

-Baza ligjore e cituar në VKB nr.7 date 07.03.2022 është e pasaktë, pasi ligji nr.9385 datë 04.05.2005 “ Për pyjet dhe shërbimin pyjor” është shfuqizuar me ligjin nr.57/2020

-Këshilli Bashkiak nëpërmjet VKB nr.07. date 07.01.2022 në dokumentin shoqërues ka njoftuar Prefektin e Qarkut Elbasan që nga lista e fondit pyllor/kullosor që do të jepen në përdorim me kontrate qiraje nëpërmjet procedurës së konkurrimit publik, disa pjesë të tyre janë zbatuar në mënyrë të paligjshme.

-Prefekti i Qarkut znj. M. P. me shkresën Nr. 310/1 Prot. datë 18.03.2022 ka konfirmuar në parim , mbështetjen e VKB nr.7 datë 07.01.2022 si të mbështetur në ligj.

-Në pikëpamjen formale janë respektuar afatet kohore të parashikuara në nenin 16, 17 të Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”;

-Prefekti i qarkut megjithëse është vendosur në dijeni për zaptimin e tokave ka miratuar pa kërkuar informacion në lidhje me zaptimin e disa pjesëve të këtij fondi pyllor/kullosor dhe nuk ka marrë masa në lidhje me këtë situatë duke vepruar në mospërputhje me nenin 8 germa “g”, “gj”, “h” dhe nenin 10 pika 1 germa a, të Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”

Nga auditimi i VKB Nr.18 datë 04.03.2022, rezulton se:

-Nuk ka referencë të bazës ligjore për marrjen me qira të mjetit.

Relacioni shoqërues i Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.18 datë 04.03.2022 është i pa plotë dhe i pa mjaftueshëm në lidhje me të dhënat, si më poshtë.

-Kërkesa e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Elbasan, mbi nevojën e marrjes me qera të makinës tip “foristrad”.

-Numri i punonjësve të administratës, të cilët kanë nevojë për të përdorur mjetin e transportit.

-Metodologjia e përcaktimit të vlerës së qerasë mujore.

-Detyrimet mbi përfshirjen e shpenzime për karburant apo shërbime të mirëmbajtjes, etj..., Referuar Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Aneksit 1 neni 4 pika 1 germa “b”, “c” dhe “d” mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan për aktet e përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të cilat nevojitet informacion shtesë plotësues për konfirmimin e ligjshmërisë së tyre, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të sigurimit të cilësisë duhet të kërkojë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore plotësimin e akteve me dokumentacion shtesë të nevojshëm për shprehjen e ligjshmërisë së tyre.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i VKB nr.32 date 04.03.2022 me objekt “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuar nga djegia e banesës” rezulton se:

Këshilli i Qarkut Elbasan ka miratuar dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmet e shkaktuara nga djegia në banesën e shtetasit zn.X. P. në shumën 1,167,434 lekë.

Institucioni i Prefektit me shkresën nr. 295/1 Prot. date 15.03.2022 “Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj” nuk e ka konfirmuar VKB nr. 32 date 04.03.2022 “ Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuar nga djegie e banesës së Znj. X. P. ” për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në VKM nr.329, date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore të tjera të shkaktuar nga veprimtari njerëzore” deri në dërgimin e dokumentacionit të plotë.

Në vijim të korrespondencës dhe kërkesës së Prefektit të Qarkut Elbasan, Bashkia Elbasan ka përcjell me shkresën 1112/3 prot. date 24.03.2022, dokumentacionin e mëposhtëm:

1.PV nga komisioni i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në objekt banimi në rast fatkeqësive natyrore.

2.Preventimin e vlerësimit të dëmeve të banesës së dëmtuar nga djegia.

3.Preventivin e bazës materiale të djegur.

4.Certifikaten për vërtetim pronësie.

5. Vërtetimin për rënien e zjarrit.

-Proces verbal është shoqëruar me dy foto të objektit nga pamja e jashtme.

-Ndër të tjera në Proces Verbal është evidentuar djegia e 1 (një) sobe elektrike.

-Në relacionin e hartuar nga komisioni është përlllogaritur vlera totale e pajisjeve të identifikuara në proces verbal, dhe për pajisjen “Soba Elektrike” nga komisioni është përlllogaritur vlera e dëmit për dy copë soba elektrike.

-Drejtorja SHMZSH pranë bashkisë Elbasan me shkresën nr. 04 prot., datë 13.01.2022 nëpërmjet vërtetimit nr. 2 date 13.01.2022 “Për rënien e zjarrit” për zjarrin e rënë në këtë banës informon se zjarri ka rënë me datë 11.02.2022 ora 23:50.

-Në proces verbalin e komisionit të vlerësimit të dëmeve si datë e rënie së zjarrit përmendet data 17.01.2022

Në dokumentacionin e Bashkisë Elbasan nuk posedohet kërkesa e familjarëve për ndihmë financiare pranë Bashkisë Elbasan si dhe ka mos përputhje të datës së rënies së zjarrit nga komisioni për vlerësimin e dëmit dhe atij të MKZ të bashkisë Elbasan.

Megjithëse dokumentacioni shtesë i kërkuar nuk ishte i plotë nga ai kërkuar nga prefekti i qarkut Elbasan nuk u plotësua nga bashkia Elbasan VKB nr.32. date 04.03.2022 u konfirmua nga Institucioni i prefektit të qarkut Elbasan me shkresës nr.295/3 Prot. date 01.04.2022.

-Nga auditimi i Vendimit nr.33 date 04.03.2022 “ Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së z. A. R., banor në “ Lagjen Skënderbej” në Lagjen nr.3 si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan”, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Elbasan ka miratuar dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan dhe vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmet e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit z. A. R. ne shumën 86,620 lekë.

-Në relacion vlere e dëmeve në banesën e z. R. P. është vlerësuar në shumën 322,829 lekë dhe vlere e dëmeve të pajisjeve dhe orendive në shumën 334,000 lekë në total 656,829 lekë. Për mungesë të dokumentacionit prefekti i qarkut Elbasan nuk e ka konfirmuar aktin.(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, për aktet që kanë si objekt “Shpërblimin financiar” në rastet e djegies së banesave të qytetarëve, duhet të kërkojë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dokumentacion shtesë kur ky është i paplotë. Njëkohësisht, duhet të sigurojë informacion plotësues nga institucionet shtetërore nën juridiksionin e qarkut Elbasan, në mënyrë që dokumentacioni për shpërblimin financiar të jetë i plotë dhe i përshtatur për rastet konkrete, përpara se të shqyrtohet ligjshmëria e tij.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të konfirmimit të akteve nga Prefektura e Qarkut Elbasan për vitin 2023, rezulton në 29 rastet e verifikuara mungon inventarizimi, numerizimi dhe arkivimi i tyre, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njëzuar me dokumentet në autoritete publike të RSH”, neni 8 germa (g).* (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Personat përgjegjës për administrimin dosjeve në bashkëpunim me specialistin e arkivës dhe protokollit, të marrin masa për inventarizimin, numerizimin dhe arkivimin e të gjitha dosjeve të përfunduara.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të konfirmimit të akteve nga Prefektura e Qarkut Elbasan, rezulton se 21 vendime të këshillave bashkiake janë marrë gjatë periudhës 4 mujore përpara datës së zgjedhjeve. Natyra e këtyre vendimeve lidhet me dhënie bursash për studentë, miratim listash emërore për familje për financimin e projekteve për përmirësim banesash, miratim listash për familje për përfitim subvencioni të interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti, përdorim fondi emergjence për situata të cilat nuk janë emergjente, miratim fondi për projekte të cilat nuk janë të miratuara në buxhet, dhurim pasurie etj... Këto vendime, konsiderohen veprimtari të ndaluara, për të cilat Prefekti i Qarkut Elbasan duhej të refuzonte konfirmimin e akteve, të cilat vijnë në kundërshtim me *Ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, neni 1, pika 1, neni 3 pika 1 nënpika 1.1 germa (a, b), 1.2, 1.3 germa (c).* (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Elbasan në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa për evidentimin dhe mos konfirmimin e vendimeve të Këshillave Bashkiake përgjatë periudhës 4 mujore përpara datës së zgjedhjeve, si veprimtari të ndaluara nga ligji.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 9 akteve të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Elbasan që lidhen me mbështetjet financiare për familje të cilat kanë pësuar dëme për shkaqe të ndryshme si tërmeti, rrëshqitje dherash, zjarri etj, rezulton se përlllogaritja e dëmeve sidomos për orenditë shtëpiake, është bërë bazuar në një shkresë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan me nr. 2382, datë 30.09.2016 si dhe nr. 5319/1 prot., datë 13.05.2016, shkresë e cila ka përcaktuar një listë çmimesh e cila ka vlera shumë të ulta si mesatare, dhe nuk përputhet me çmimet aktuale të tregut, duke mos mundësuar një ndihmë të përshtatshme dhe në raport të arsyeshëm me dëmet e shkaktuara për këto familje, të përcaktuara në pikën 3 germa (d) të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Elbasan, të bashkërendojë punën me Këshillat e Bashkive të Qarkut Elbasan si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me synimin përditësimin e një listë çmimesh për orenditë, të cilat janë dëmtuar për shkak të fatkeqësive natyrore, kjo për të mundësuar një ndihmë të arsyeshme për familjet në nevojë, e cila të përktojë me çmimet aktuale të tregut.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i konfirmimit të aktit me nr. 445/1 prot., datë 19.04.2023 të vendimit të KB Librazhd me nr. 26, datë 31.03.2023 *“Për miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga fatkeqësi natyrore”* në vlerën 325,809 lekë, rezulton se kemi 2 trajtime për të njëjtin subjekt me objekt të ndryshëm fatkeqësie. Në rastin e parë banesa e të dëmtuarit konsiderohet se ka ardhur nga tërmeti, ndërkohë sipas urdhrit të titullarit të Bashkisë Librazhd me nr. 280, datë 15.03.2023 për ngritjen e komisionit për vlerësimin e dëmeve, është përcaktuar se fatkeqësia ka ardhur nga rrëshqitjet e tokës. Sa më sipër, nuk argumentohet se para cilës fatkeqësi ndodhemi, dhe referuar dokumentacionit të nevojshëm për situatën e dytë që lidhet me rrëshqitjet e tokës, ka mangësi të dokumentacionit pasi mungon procesverbali i konstatimit të rrëshqitjes dhe studimi gjeologjik i hartuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ose subjekte të licencuara nëse është rrëshqitje toke, veprime në kundërshtim me pikën 2, germa (a, e), të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Elbasan dhe administrata e tij, të bëjë verifikim të plotë të praktikave, duke shmangur situatat ku për të njëjtin objekt, pasqyrohen 2 situata të ndryshme fatkeqësie. Të kërkohej dokumentacioni i plotë përpara konfirmimit të aktit nga prefekti.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimit të KB Gramsh me nr. 31, datë 10.05.2023 *“Për anulim të vendimit nr. 18, datë 28.02.2023 “Për dhënie e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi kullor publik për ndërtimit dhe operimin të HEC-eve “KUKUR 3” dhe “KUKUR 4” nga Shoqëria “K.” SHPK”*, rezulton se është vendosur anulimi i vendimit nr. 18 me argumentin se bie ndesh me Kodin Zgjedhor dhe Vendimin Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, duke sqaruar edhe elementët të cilët konsiderojnë se bie ndesh ky vendim, si dhe mungesën e kuorumit për çështjet jashtë rendit të ditës. Prefekti i Qarkut Elbasan ka kthyer përgjigje KB Gramsh ku i kërkon shkaqet ligjore që ka marrë në konsideratë KB për anulimin e vendimit të mëparshëm, ndërkohë që shkaqet janë paraqitur në këtë vendim dhe nuk janë trajtuar nga Institucioni i Prefektit, duke mos i dhënë përgjigje çështjeve të trajtuara në këtë vendim, në kundërshtim me nenin 16, pika 2 germa (b/i) të ligjit nr. 107/2016 *“Për prefektin e qarkut”*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Elbasan, në rast kthimi të aktit për rishqyrtim, të përcaktojë papajtueshmërinë ligjore të vendimit të ardhur për konfirmim, duke argumentuar shkeljet e vërejtura.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimit të KB Belsh me nr. 43 dhe 2026 prot., datë 31.07.2023 me objekt *“Për miratimin e procedurës së vlerësimit për objektin (shtëpi banimi) të z. A. A. Q. të dëmtuar nga zjarri”*, ka rezultuar si vijon:

-Sipas këtij vendimi, miratohet procedura e vlerësimit të dëmeve për objektin e këtij shtetasi me vlerë financiare gjithsej 1,571,843 lekë për objektin dhe për orenditë. Në praktikën e administruar nuk disponohet kërkesa e palës së dëmtuar, si dhe urdhri për ngritjen e komisionit për kryerjen e vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të Kreut III, pika 1 të VKM-së nr. 629, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*. Praktika e mësipërme është kthyer nga Prefekti i Qarkut Elbasan ku kërkohen të dhëna shtesë dhe duke përcaktuar se vendimi nr. 43, datë 31.07.2023 është i pa plotë si nga ana formale dhe nga përmbajtja, pasi miraton procedurën por nuk miratohet vlera e dëmshpërblimit. Në përgjigje, Bashkia Belsh ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3308/1 prot., datë 31.11.2023 ku ka bashkëngjitur vendimin nr. 43, datë 28.07.2023 duke përcaktuar se është sipas formatit dhe kërkesave të cituara në shkresën e Prefektit për kthimin e aktit. Konstatohet se Vendimi nr. 43, dhe nr. 2026 prot., datë 31.07.2023, i cili i është bashkëngjitur shkresës së mësipërme, ka përmbajtje tjetër në objektin e tij dhe konkretisht *“Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e z. A. A. Q., banor i fshatit Hardhi, Njësia Administrative Fjerzë si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga ana e Bashkisë Belsh”*, me vlerë financiare e dëmshpërblimit 785,921 lekë.

Rezulton se janë paraqitur 2 vendime që mbajnë nr. 43, nr. 2026 prot., datë 31.07.2023, por në objekt, përmbajtje dhe në vlerën financiare janë të ndryshme. Pavarësisht mangësive në formë dhe përmbajtje, është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 871/3 prot., datë 08.12.2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Elbasan, të marrë masa dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shqyrtimin e këtij akti, pasi kemi të bëjmë me të njëjtin numër akti por me përmbajtje të ndryshme dhe vlera të ndryshme, duke mos dhënë garanci për një shqyrtim korrekt nga punonjësit e ngarkuar të Prefekturës, si dhe mohimin e dhënies së ndihmës së përshtatshme për personin të cilit i ka ndodhur fatkeqësia natyrore.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i akteve normative të miratuara nga Prefekti për periudhën objekt auditimi, rezultoi se në 5 raste *“Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, ndërtesa në pronësi të Bashkisë Librazhd”*, mungon dokumentacioni pronësor i detyrueshëm i objekteve, mungon mënyra e përfitimit të pasurive (Institucioni përgjegjës për administrim), nëse kanë ardhur si rezultat i transferimit nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë vendore referuar dispozitave të ligjit nr. 8744 datë 22.01.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”* (Miratimi nga Këshilli i Ministrave, së bashku me dokumentacionin përkatës), mungojnë arsyet e nxjerrjes nga përdorimi, vlerësimet e ekspertit të fushës si dhe metoda që propozohet për daljen nga përdorimi referuar udhëzimit nr. 11, datë 06.05.2016 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, konkretisht;

- VKB nr. 16 date 28.02.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 1781/1 prot., datë 12.04.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan;

- VKB nr. 67 date 29.07.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 3590/5 prot., datë 01.08.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan;
- VKB nr. 23 date 29.03.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 1663/4 prot., datë 05.04.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan;
- VKB nr. 91 date 28.10.2022 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 4905/4 prot., datë 31.10.2022 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan.
- VKB nr. 32, datë 21.06.2023 dhe dokumentacionit bashkëlidhur shkresës nr. 32 prot., datë 03.07.2023 përcjell Prefekturës së Qarkut Elbasan.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Aneksit 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Prefektura e Qarkut Elbasan të marrë masa që të mos pranojë dhe konfirmojë aktet normative të dërguara nga Bashkitë të pa shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues i cili garanton se vendimmarrja ka respektuar të gjitha përcaktimet ligjore kur jepet në përdorim apo shfrytëzim një pasuri publike. Gjithashtu, të kërkohet nga Bashkitë që i gjithë dokumentacioni i dërguar nga Bashkitë të jetë i inventarizuar dhe me listën e dokumentacionit që përmban dosja.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u konstatua se në 8 raste VKB-të nuk kanë qenë të shoqëruara nga dokumentacioni i nevojshëm për shqyrtimin e ligjshmërisë konkretisht

- VKB nr. 85, date 30.09.2022 “Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik “Zgjerimi i Miniparkut të Qershive + Ndërtimi i Vend parkimit për automjetet”, zk. 2446 nga Bashkia Librazhd dhe burimi i financimit të këtij projekti shpronësimi”, Bashkia Librazhd;
- VKB nr. 18, datë 17.02.2023 “Për miratimin e ndërtimit të varrezave të reja në lagjen qendër, fshati Xhyrë, NjA Hotolisht”, Bashkia Librazhd;
- VKB nr. 42, datë 28.04.2023 “Për dhurimin e pasurisë nr. 7/143-A me sipërfaqe 217 m² në favor të Komunitetit Mysliman Shqiptar, Bashkia Librazhd;
- VKB nr. 51, datë 31.05.2022 “Për miratimin e hapjes së rrugës auto në fondin pyjor/kullosor” Bashkia Librazhd;
- VKB nr. 84 date 04.10.2022 “Për përdorim të sipërfaqes për zhvillimin e Blegtorisë”, Bashkia Librazhd;
- VKB nr. 68, datë 19.08.2022 ka miratuar nisjen e procedurës “Për miratimin e ndryshim funksioni të objektit ish magazina e Rezervave të shtetit në palestër për shkollën Ahmet Elezi Stravaj”, Bashkia Përrenjas;
- VKB nr. 68 date 15.12.2023 “Mbi shpronësimin e pasurive që preken për efekt të zgjerimit të sipërfaqeve të varrezave publike të qytetit të Peqinit”, Bashkia Peqin;
- VKB nr. 13, datë 24.02.2023 ka miratuar nisjen e procedurës “Miratimin e Analizës së Kostos për shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane”, Bashkia Peqin.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me gërmën b të nenit 4 të Aneksit 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandimi: Prefektura e Qarkut Elbasan të marrë masa që të mos pranojë dhe konfirmojë aktet normative të dërguara nga Bashkitë të pa shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm justifikues i cili garanton se vendimmarrja ka respektuar të gjitha përcaktimet ligjore të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit, me interes publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vendimit me nr. 39, datë 20.04.2022 të KB Elbasan me objekt *“Mbi marrjen me qira të një mjeti (rinovim kontrate), për plotësimin e nevojave të transportit të administratës së Bashkisë Elbasan”*, rezulton se është përcaktuar vlera 75,000 lekë/muaj për marrjen me qira të një mjeti për tu përdorur për plotësimin e nevojave të Administratës së Bashkisë. Konfirmimi i këtij vendimi nga Prefekti i Qarkut për një shpenzim prej **900,000 lekë** në vit për marrje mjeti me qira, nuk mbështetet në ligj, duke konfirmuar një shpenzim pa efektivitet për buxhetin e Bashkisë Elbasan. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 *“Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civil” i ndryshuar*, i cili nuk përcakton marrjen e mjeteve me qira për administratën e bashkisë, në asnjërin nga lidhjet e këtij ligji.

-U verifikua konfirmimi i Aktit me nr. 503 prot., datë 05.05.2023 i Vendimit të KB me nr. 49, datë 25.04.2023 me objekt *“Për financimin e aktiviteteve të Federatës Shqiptare të Çiklizmit”*.

Sipas këtij vendimi, përcaktohet financimi në vlerën **1,500,000 lekë** për Federatën Shqiptare të Çiklizmit për aktivitetin *“80 Tour of Albania”*. Në dosjen e përcjellë për konfirmim pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, nuk disponohet kërkesa nga Federata Shqiptare e Çiklizmit, mungon preventivi për përlogaritjen e këtij financimi, nuk është përcaktuar klasifikimi sipas programit ekonomik nga Bashkia Elbasan, dhe kapitujt respektiv nga ku do bëhet miratimi i fondeve që do preken. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1. faqet 18-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Elbasan, dhe personat e ngarkuar për trajtimin e vendimeve sipas këtij objekti, të kryejnë konfirmimin e akteve të kësaj natyre vetëm pasi të evidentohet se plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës, duke shmangur mundësinë e shpenzimeve pa efektivitet për marrjen e mjeteve me qira.

-Sektori i Financës të bëjë shqyrtimin e plotë të praktikave, duke kërkuar nga këshillat bashkiak dokumentacionin e plotë justifikues për shpenzimin e planifikuar, si dhe programin ekonomik që preket për miratimin e këtij fondi.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, neneve, 57, 58, 59 të Ligjit nr. 152/2013 datë 17.10.2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreut II, pika 2 të VKM nr. 115 datë 05.03.2015 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”*, të ndryshuar, **i rekomandojmë Prefektit të Qarkut Elbasan**, ti kërkoj komisionit disiplinor të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për **5 (pesë)** punonjësit, si më poshtë:

a) “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, germa (c) neni 58”.

1. Z. A. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik;

2. Znj. A. G., me detyrë Specialist Jurist në Sektorin Juridik.

Për mangësitë si më poshtë:

- **Në lidhje me** mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor

për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me germën (a) neni 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”. (Trajtuar gjerësisht në faqet 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b) “Vërejtje”

3. Z. E. G., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe Krizave;

4. Znj. A. Z. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës;

5. Z. A. K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban;

Për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Aneksit 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”. (Trajtuar gjerësisht në faqet 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D.1. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i Auditimit, **lihet në kompetencë dhe vlerësim të Prefektit të Qarkut Elbasan**, fillimi ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës për **5 (pesë)** punonjës, si më poshtë:

1. Z. F. D. me detyrë Specialist në Mbikëqyrjen e Mjedis;

2. Z. G. U. me detyrë Specialiste pran Sektorit Urban;

3. Z. A. B. me detyrë Specialist i Emergjencave Civile dhe Krizave;

4. Znj. S. S. me detyrë Specialiste pran Sektorit të Finance;

5. Znj. A. M. me detyrë Specialiste Turizmi dhe Funksionet e Deleguara.

Për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me pikën b të nenit 4 të Aneksit 1 mbi rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga prefekti i qarkut të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”. (Trajtuar gjerësisht në faqet 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D.2. Mbështetur në nenin 15 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 5 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin” dhe Urdhrin nr. 175, datë 09.07.2020 të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Prefektit të Qarkut si dhe aneksin i të rregullave për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, **i, rekomandojmë Ministrit të Brendshëm**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për ish-Prefektin e Qarkut Elbasan **Znj. M. P.**, për mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të germa (a) nenit 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin”, trajtuar gjerësisht në faqet 17 - 65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, germa (c) neni 58”* përkatësisht:

- 1. Znj. L. B.**, me detyrë Ish/Sekretare e Përgjithshme;
- 2. Znj. E. Z.**, me detyrë ish/Specialiste e Sektorit Juridik;
- 3. Znj. G. T.** me detyrë Ish/Specialiste e Sektorit të Zhvillimit Urban;
- 4. Znj. M. Q.** me detyrë Ish/ Specialiste pranë Sektorit të Finance.

-Në lidhje me mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të ligjshmërisë së akteve normative dhe mungesës së administrimit të dokumentacionit tekniko ligjor për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, në kundërshtim me germën (a) neni 8 dhe neni 16 të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 *“Për Prefektin”*. (Trajtuar gjerësisht në faqet 37-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Prefektura e Qarkut Elbasan pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, i ndryshuar.
- b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT